



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

PROCESVERBAL

Tiranë, datë 16.12.2020, ora 13:00

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore e përbashkët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas lidhur me prezantimin e raportit nga UNFPA "Analiza e Politikave të Përgjegjshme Gjinore për Familjen në Shqipëri".

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Almira Xhembulla, Majlinda Halilaj, Florenc Spaho, Eugen Bojaxhiu, Amra Barova, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Halil Jakimi, Ervis Meço, Roland Xhelilaj, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Elona Hoxha Gjebrea, Amra Barova, Musa Ulqini, Rudina Hajdari, Antoneta Dhima, Ediola Braha.

Të ftuar:

Fiorela Shalsi - përfaqësuese UNFPA

Elsona Agolli - përfaqësuese UNFPA

Blerita Kolavaçe - përfaqësuese UNFPA

Blerina Metanj - përfaqësuese UNFPA

Vjollca Koko – mjeke reumatologe

Bruna Ylviu – përfaqësuese e Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin.

Eni Mjeshtri – përfaqësuese e Qendrës për të Drejtat në Punë.

Olta Koçi - specialiste

Migena Balla - specialiste

Irena Nikaj - specialiste

HAPET MBLEDHJA

Fiorela Shalsi – Të nderuar panelistë,

Zoti Roshi, zonja Gjermani, zonja Agolli,

Të nderuar deputetë,

Zonja të Aleancës së Grave Deputete,

Zonja këshilltare,

Përfaqësues të institucioneve të ndryshme shqiptare,

Përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të biznesit privat, shoqërisë civile, akademikë, ekspertë, aktivistë, gazetarë dhe bashkëpunëtorë,

Të nderuar kolegë, dhe pjesëmarrës *online* dhe pjesëmarrës në sallë,

Mirëmëngjesi dhe mirë se erdhët!

Kam kënaqësinë e veçantë që sot të prezantoj përpara jush këtë publikim si produkt të parë të projektit rajonal të zbatuar nga UNFPA-ja “Më shumë zgjedhje. Politikat e përgjegjshme gjinore për familjen dhe sektorin privat në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi”.

Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Agjencia Austriake e Zhvillimit ADA.

Shumë prej jush kanë qenë të pranishëm në lançimin e këtij projekti pak kohë më parë, ku ne ju informuam për lançimin e këtij prezantimi sot dhe jemi shumë të nderuar që pikërisht në këtë prezantim ne patëm interesin e menjëhershëm dhe bashkëpunimin e plotë të dy strukturave shumë të rëndësishme të parlamentit shqiptar, Komisionit për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas. Kjo analizë është kryer nga IDRA Research Consulting dhe synon të ofrojë një panoramë të mjedisit ligjor ekonomik dhe shoqëror për politikat e përgjegjshme gjinore për familjen në Shqipëri. Ne shpresojmë që kjo analizë, përmes informacionit që do të përcjellë, të jetë e dobishme jo vetëm në nivelin individual të secilit prej nesh, sepse ka informacion që lidhet me jetën e secilit prej nesh, por gjithashtu edhe në nivelin profesional, shoqëror dhe, mbi të gjitha, institucional. Ne synojmë, në fakt, që kjo analizë të nxisë një diskutim për përmirësimin e politikave më miqësore dhe të ndjeshme gjinore për familjet shqiptare.

Sipas rendit të ditës në seancën e parë ne do të kemi kënaqësinë të dëgjojmë fjalën e panelistëve dhe pas kësaj seance unë do t’ju lutesha për 2, ose 1 minutë të ndiznit kamerat për një foto *online*, duke pasur parasysh kushtet në të cilat ne po e zhvillojmë këtë takim. Më pas, në seancën e dytë, do të bëjmë prezantimin kryesor pse jemi sot këtu, pra të analizës, ku do të jeni të ftuar patjetër për sugjerimet, vlerësimet, komentet dhe rekomandimet tuaja.

Pa humbur kohë kam kënaqësinë t'ia jap fjalën përshëndetëse zonjës Agolli, koleges time të dashur, analiste e programit për çështjet gjinore dhe të popullsisë, e cila, përveç shumë përgjegjëseve dhe funksioneve të saj ka qenë dhe një nga ideatoret dhe kontribuueset kryesore të hartimit të këtij projekti nëpërmjet të cilit ne kemi mundësinë që të mblidhemi sot dhe të dëgjojmë produktin e parë të këtij projekti.

Fjala për ju, zonja Agolli.

Faleminderit!

Elsona Agolli – Mirëmëngjesi të gjithëve dhe ju falënderoj që ndodhni si *online* dhe *offline* në këtë mënyrë deri diku hibride të organizimit të eventeve, megjithëse ne do të vazhdojmë të flasim sikurse është thënë një shprehje, që shfaqja teatrale do të vazhdojë edhe sikur të ketë vetëm një vëzhgues në skenën e teatrit!

Po vazhdoj pa humbur kohë.

Në këtë event faktikisht shumë të rëndësishëm dhe që merr vlerë më shumë pikërisht për faktin se ne përpiqemi të vazhdojmë të gjitha aktivitetet tona ashtu siç i kemi planifikuar pavarësisht nga vështirësitë që janë krijuar nga pandemia, si në mënyrë fizike, ashtu dhe në organizimin dhe koordinimin e të gjitha gjërave. Megjithatë kemi pasur një mbështetje pa masë nga të gjithë ata që kanë bërë të mundur këtë analizë, por edhe lançimin e saj. Kështu që do të doja të falënderoja shumë zotin Enver Roshi, kryetar të Komisionit për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, zonjën Eglantina Gjermani, nënkryetare të Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, gjithashtu të gjithë kolegët e UNFPA-së, por dhe më tej, si dhe të gjithë partnerët, të cilët ndodhen sot nëpërmjet *zoom*-it dhe na ndjekin nga afër!

Faleminderit shumë!

Ajo që ne lançojmë sot është një analizë e politikave të përgjegjshme gjinore për familjen, e cila ka ardhur si rezultat i një pune shumë intensive, Fjorela ka punuar shumë për këtë gjë dhe e falënderoj, gjithashtu edhe partnerët tanë implementues *Landways Internacional*, të cilët në mënyrë shumë këmbëngulëse kanë bërë të mundur një punë cilësore për të sjellë atë analizë që *IDRA Research Consulting* realizoi për disa muaj, duke vlerësuar kuadrin e politikave, kuadrin ligjor, por dhe statistikën, që Shqipëria vë në dispozicion për të vlerësuar siç duhet nëse kemi, apo jo politika të përgjegjshme ndaj barazisë gjinore.

Sikurse ju kemi informuar në tetor, kur lançuam projektin që është mbështetur dhe që do të mbështetet për 3 vitet në vazhdim, duke filluar që nga ky vit nga Agjencia Austriake e Zhvillimit, kjo analizë është pjesë e aktiviteteve të planifikuara në këtë projekt dhe, përpara se të kalojmë në një zbatim më konkret në bashkëpunim me sektorin privat, me institucionet është

mirë të dimë realitetin në të cilin ndodhemi dhe sa mbështetës është për politikën ndaj jetës së balancuar në familje dhe që mundëson fuqizimin gjinor.

Barazia mes burrave dhe grave është një vlerë themelore dhe një kusht për zhvillimin ekonomik konkurrues dhe zhvillim të qëndrueshëm. Sikurse e dimë në Strategjinë Europiane për Barazinë Gjinore 2020-2025 shprehet domosdoshmëria e rritjes së pjesëmarrjes së gruas në tregun e punës dhe në këtë rast kjo gjë është shumë e domosdoshme, sepse nuk është thjesht për të përthithur talentin që gratë përfaqësojnë dhe mbartin me vete, por edhe për të krijuar një shoqëri përfshirëse, të ndjeshme dhe të qëndrueshme. Ne jemi të gjithë kontribuues në përpjekjet pa fund, që kanë ndodhur për të përmirësuar barazinë gjinore në këto dekada, si dhe jemi dëshmitarë të reformave ligjore të përmirësimit të strategjive, të cilat po ndodhin jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën, me qëllim që të heqim dorë dhe të luftojmë, pra të ngrihem kundër ligjeve diskriminuese, që dëmtojnë këtë barazi.

Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha zhvillimet, pavarësisht nga përmirësimi i legjislativitetit, ligjit të punës, Kodit të Familjes ne vazhdojmë të shohim që pjesa më e madhe e grave në të gjithë botën, qoftë në vendet në zhvillim, qoftë në ato më të pazhvilluara deri diku paguhen 60-75% më pak sesa pagesa që marrin burrat në sektorin e punësimit. Gjithashtu, mundësitë e grave për t'u punësuar dhe qëndruar në punë shpeshherë, dhe ne jemi dëshmitarë, janë më të ulëta se ato të burrave dhe shanset për gratë që të qëndrojnë në sektorin e punës janë më të vogla se ato të burrave. Megjithatë punësimi i gruas është i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe zhvillimin në përgjithësi. Asnjë vend nuk ka mundësi të humbasë forcën e gruas nga sektori i punësimit, prandaj kërkohet një angazhim edhe më i mirë qoftë i shtetit, i qev erisë, por i sektorit privat të punësimit, që përbën pjesën më të madhe të forcës në punë.

Disa prej kolegëve këtu, zonja Eglantina, po ashtu, shikoj edhe kolegë në Zoom, kanë qenë në Najrobi në vitin e kaluar dhe tashmë ka kaluar një vit, por që nga ICPD-ja në Kajro, në vitin 1994, kur kanë kaluar 26 vjet, barazia gjinore u vendos edhe një herë në fokus të UNFPA-së dhe vazhdon të mbetet një nga fushat dhe drejtimet kryesore të punës sonë. Një vit më vonë, ne vazhdojmë të mbështesim dhe të këmbëngulim që barazia duhet të jetë dhe mbetet një nga objektivat kryesore për të sjellë rezultate transformuese, por që nuk mund të realizohet pa përfshirjen e djemve dhe burrave. Burrat, si baballarë, bashkëshortë, partnerë luajnë një rol të rëndësishëm në familje dhe përmes këtij projekti ne kërkojmë të inkurajojmë këtë pjesëmarrje dhe kontribut të barabartë në rritjen, kujdesin në familje dhe ndarjen e punës, por edhe marrjen pjesë në argëtimin e përditshëm të të gjithë anëtarëve të saj.

Qeveritë duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të përshtatur politika dhe iniciativa që mbështesin si biznesin, ashtu dhe individët.

Ne sot do të ndajmë gjithashtu disa nga praktikat e mira të vendeve që i kanë ndërmarrë ato për të realizuar këto synime, pra një jetë të balancuar në familje dhe përfshirjen e institucioneve që punësojnë njerëzit për ta mbështetur këtë iniciativë. Prandaj është e domosdoshme që politikat, të cilat adresojnë pabarazitë të krijojnë kushtet e duhura dhe të stimulojnë gratë që punojnë. Është më se e arsyeshme që kompanitë të krijojnë mjedise pune, të cilat tërheqin gratë në punësim dhe i mbajnë ato.

Subvencionimi i kujdesit ndaj fëmijës, ofrimi i lejes prindërore, orët fleksibël të punës, sfidat e normave diskriminuese gjinore brenda kompanive, do të rrisim mundësitë që gratë të hyjnë në punë dhe të bëjnë një ndarje më të mirë të punës së papaguar me bashkëshortët dhe partnerët e tyre. Për ne, pjesëmarrja e Komisionit parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, si dhe e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, janë tregues të angazhimit politik, institucional, që së bashku do të realizojmë diçka në këtë drejtim.

Gjej rastin për t'ju falënderuar edhe një herë, zoti Roshi, si dhe ju, zonja Eglantina, që keni bashkuar forcat me ne për të punuar së bashku në këtë ndërhyrje, që ka për qëllim të shtojë dhe të zgjerojë mundësitë e burrave dhe grave për të punuar, sidomos në këto kohë të vështira, të krijuara dhe nga pandemia!

UNFPA-ja do të vazhdojë të jetë e vendosur në këtë kauzë kaq të rëndësishme, por dhe në partneritetin me ju, si dhe me të gjitha institucionet qoftë shtetërore, qoftë private, me qëllim që të realizojmë këtë mision.

Faleminderit!

Fiorela Shalsi – Faleminderit, Elsona, për panoramën e gjerë të çështjeve shumë kritike, adresimi i të cilave ndihmon në arritjen e barazisë gjinore, që ne po mundohemi t'i sjellim në një panoramë specifike për Shqipërinë sot dhe të shpresojmë më pas në bashkëpunimin e aktorëve shumë kyçë, me të cilët ne synojmë të sjellim ndryshimin në Shqipëri!

Kam kënaqësinë e veçantë t'ia jap fjalën zotit Roshi, i cili me kontributin e tij personal ndër vite, aq më tepër në rolin e tij specifik në drejtimin e Komisionit të Shëndetësisë, ndihmon pikërisht në adresimin e këtyre çështjeve.

Faleminderit që jeni këtu, zoti Roshi, në këto kushte të vështira, si dhe për fjalën tuaj!

Enver Roshi – Faleminderit, Elsona!

Faleminderit, zonja Gjermani!

Njihemi prej kohësh dhe për mua është një kënaqësi e veçantë që, në cilësinë e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, vij sot këtu të jap mbështetjen time për gjithë punën tuaj. Aktualisht UNFPA-ja ka qenë inspiruese e vazhdueshme i të gjitha nismave ligjore të prezantuara në Kuvend, një mbështetëse kryesore e barazisë gjinore.

Unë kam kënaqësinë që me zonzjën Eglantina dhe zonzjën Agolli njihem prej vitesh (me zonzjën Eglantina na solli shansi që të jemi dhe në parlament, përveçse vijmë nga universiteti) dhe ndajmë mendime të njëjta, mbështetëse në lidhje me barazinë gjinore në Shqipëri.

Aktualisht Shqipëria po kalon një moment të vështirë me COVID-in, po kalon një moment të vështirë edhe pas situatës me tërmetin, ku kuptohet që shumë financa dhe burime buxhetore shkojnë për ndërtimin, rehabilitimin, por edhe në mbështetjen e stafeve shëndetësore dhe burimeve shëndetësore për përballimin e krizës së COVID-it, si dhe të tërmetit.

Vazhdimisht kam folur me deputeten, me miken time Gjermani, që e quaj mike, sepse kemi një kohë të gjatë që punojmë së bashku dhe sfera e shëndetit publik është shumë e gjerë, ku edhe sfera e shkencave sociale është e përfshirë në tërësi dhe qëllimi i tyre është shëndeti i njerëzve, që barazia gjinore në Shqipëri të marrë vëmendjen e duhur.

Historikisht ne vijmë nga një shoqëri patriarkale, ku roli i burrit në shtëpi është dominues. Unë vetë kam qenë mjek, kam punuar në zonat veriore të Lumës e Kukësit dhe e kam parë nga afër trajtimin e gruas në zona të tilla. Kur më duhej të ulja vdekshmërinë foshnjore në këto zona, që ishte shumë e lartë, 70 për mijë, kur unë vajta si mjek i përgjithshëm në Bushtricë (këtë shifër as vendet e Afrikës nuk e kishin, se e kishin më të ulët), bëhet fjalë për vitet '86-'90, komunikimi i vazhdueshëm ishte vetëm me gratë, nënat, gjyshet, për të kontribuar që ushqyerja, që ishte faktori kryesor i vdekshmërisë foshnjore, të shkonte te gratë shtatzënë, te fëmijët, pasi atje ishte mentaliteti që ushqyerja më e mirë ishte për burrat, vjehrrit dhe për të sëmurët meshkuj. Bashkëpunimi dhe partneriteti me gratë bëri që unë të ulja vdekshmërinë foshnjore (ky është një shembull personal) në 17 për mijë, kur u largova nga Kukësi. Kjo është një bazë se si ne mund të bashkëpunojmë me gratë.

Gruaja përbën 50% të shoqërisë dhe unë jam i lumtur që, kur kam qenë jashtë dhe kudo që kam dalë, kam parë se gruaja shqiptare përballon sfidat, është lider, organizon biznesin, merr pjesë në politikë dhe shoqëria shqiptare duhet të bëjë më shumë, në veçanti për gratë.

Unë, si ekspert i shëndetit publik, por edhe nga fusha prej nga vij, dua që gruan ta shoh gjithnjë pjesëmarrëse.

Ne sot jemi të lumtur që një pjesë e ministreve të qeverisë janë gra, por do të isha i lumtur të kisha edhe një kryeministre grua, sepse gruaja ofron më shumë liberalizëm, ofron më shumë qetësi, komunikim, bashkëpunim, edhe në kuptimin social e sheh më ndryshe shoqërinë

njerëzore, aq më tepër që ne, si Komision Shëndetësie, së bashku me Eglantinën, kemi kaluar disa ligje. Ligji i parë kërkonte një shumë prej 2 milionë eurosh, që ishte për mbështetjen e grave në bashki, në pushtetin qendror dhe lokal, për mbështetjen e biznesit të gruas. Eglantina ndoshta mund të elaborojë më shumë për këtë ligj, por ne gjithmonë kemi qenë të hapur. Unë e quaj veten fatlum që sot jam pjesë e ligjvënësve, që bashkëpunoj me ju dhe jam i hapur për çdo ndryshim që paraqitet në Kuvend, në Komisionin e Shëndetësisë apo nënkomision bashkë me zonjën Eglantina Gjermani.

Në treguesit e punësimit, treguesit shëndetësor, treguesit socialë e të tjerë unë shikoj se ne gjithmonë mbetemi prapa në krahasim me treguesit e Komunitetit Europian, ëndërr që shqiptarët nuk e kanë sot, sepse prej 500 vjetësh kërkojmë të shkojmë në Europë. Kjo kërkon ndryshim mentaliteti, një mentalitet Perëndimor, të hapur dhe jo mentalitet Lindor. Ne si shoqëri kemi ndryshuar, por emancipimi i gruas është pjesa më e dhimbshme, më e vështirë që ne duhet të bëjmë. Gratë duhet të jenë më të arsimuara, më të punësuara, të kenë barazi të njëjtte financiare si burrat.

Unë pashë treguesit shëndetësorë dhe vdekshmëria në sëmundje kronike për gratë është më e lartë se sëmundjet cerebrale. Kuptohet, shkaku kryesor i sëmundjeve cerebrale janë problemet e hipertensionit. Gratë jetojnë më shumë se burrat, kjo dihet, por kemi probleme me kancerin e gjirit apo kancerin e qafës së mitrës, sepse edhe kur mamografitë shkojnë në rrethe, pjesëmarrja e grave për të bërë mamografi është e ulët.

Para shumë vjetësh kam pasur një eksperiencë personale dhe mund ta ndaj me ju. Në fshatin Çerkezë të Tiranës, një grua e varfër e kishte të pamundur të vinte për trajtim për kancerin e gjirit në Tiranë. Ne nuk duhet të krenohemi për vetekzaminimin e kancerit të gjirit nga gratë. Kur kapet kanceri i gjirit nga vetekzaminimi, do të thotë se situata është alarmante, është shumë vonë. Ne duhet të testojmë në faza të hershme, të parandalimit, të diagnostifikimit të hershëm të sëmundjes. Duhet bërë *check up-i*, i cili është një filozofi e mirarrirë e shëndetit publik në Shqipëri. Gratë, sipas protokollit, duhet të shkojnë një herë në vit për të bërë mamografi, sipas moshës apo faktorit të rrezikut.

Nga ana tjetër, jo vetëm kaq, por gratë kanë fituar edhe statuse të tjera, siç ai i lindjes. Ne sot po përballemi me atë që quhet plakja e popullsisë shqiptare. Fertiliteti i grave është 1,37% më i ulët se ai i mesatares europiane. Kjo është një situatë e vështirë dhe mendohet që plakja e popullsisë shqiptare të vazhdojë edhe për vitet e ardhshme.

Sipas studimeve të DGS-it, në dy raportet e veta, në Shqipëri ka ende njerëz në pushtet, që nuk e kuptojnë rëndësinë e DGS-it, i cili duhet bërë 1 herë në 5 vjet. Ne kemi qenë vërtet në vështirësi financiare për t'u mbështetur nga qeveria dhe unë e falënderoj UNFPA-në për

shumën financiare të dhënë, që plakja e popullsisë është një fenomen mbarë europian, veçanërisht për Shqipërinë.

Jo vetëm kaq, por edhe raporti i lindjeve meshkuj–femra është më i madh për meshkuj sesa për femrat, megjithëse ky raport ka rënë. Tendenca është që në zonat rurale preferohen më shumë meshkuj se femra dhe në zona urbane preferohen më shumë femra se meshkuj. Në një studim, shkencëtari ynë i shquar, Agron Gjonçaj, i cili është në Londër, nxori këtë fenomen në trevat shqiptare. Unë mendoj se mbetet shumë për të bërë edhe për sa i përket lejes së lindjes, bonusit të lindjes, lejes së lindjes për burrat dhe ruajtja e vendit të punës për gratë shtatzëna. Këto janë disa nisma që e garantojnë gruan të jetë pjesë e shoqërisë dhe të ruajë statusin ekonomik që ka.

Unë mund të them se punësimi i grave, rritja e të ardhurave të grave dhe fuqizimi ekonomik i gruas shqiptare do ta bëjë atë më independente dhe më të pavarur nga burri. Familja shqiptare do të liberalizohet më shumë në kuptimin e mirë të fjalës. Pjesëmarrja e burrit në punët e shtëpisë do të jetë më e madhe, duke e shtuar gruan si pjesë e shoqërisë. Këtu e kam fjalën edhe për pjesë të tjera të shoqërisë.

Kam bërë debate të shumta për pjesën Lindore të kontinentit, ku gruaja është e shfrytëzuar, nuk trajtohet si duhet. Një grua përbën 50% të shoqërisë, ka edhe kujdesin e fëmijëve, i bie që 75% e shoqërisë del jashtë përkrahjes sociale, vetëm 25% merr pjesë në shoqëri, siç janë në vendet arabe apo më lart, në Arabi Saudite, ku gruaja vuan nga shumë probleme sociale, dhe jo vetëm kaq, por trajtohet në mënyrë shumë çnjerëzore në vendet si: Afganistani, Irani dhe shumë vende të tjera, që janë prapa nesh.

Unë dua ta them me krenari se ne, fatmirësisht, kemi bërë shumë hapa para, por sërish nuk janë të mjaftueshëm, sepse ende jemi të pakënaqur me statusin që gruaja duhet të ketë në shoqërinë shqiptare, pasi në zonat rurale gratë punojnë më shumë se burrat, të cilët përqendrohen në lokale, ndërkohë që gruaja merret me punët e shtëpisë, merr ujin larg, nuk ka lavatriçe, nuk ka frigoriferë, nuk ka kushte gatimi, nuk ka kushte për fëmijët. Për të gjitha këto ndikon statusi ekonomik i gruas, i cili duhet përmirësuar. Përmirësimi i mirëqenies së njerëzve do të bëjë të shtohet edhe përmirësimi i mirëqenies së gruas në familje.

Ndoshta u zgjata, por ky diskutim nuk shteron kurrë, është i pafund, siç është e pafundme energjia dhe arti shpirtëror i gruas, që për mua është një dritare që hyn dhe hap shumë dritare të tjera të pafundme të artit, kulturës, të punës e të tjera. Unë ju mbështes dhe kjo falë inspirimit që kam pasur nga shumë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, veçanërisht Eglantinës, që kemi folur vazhdimisht për këtë gjë. Çdo propozim, çdo amendim ligji dhe çdo risi që do ta sjellin në Kuvend, është i mirëpritur të diskutohet në komisione, që ta kthejmë në një nismë

ligjore dhe t'i japim një shtytësë qeverisë dhe në parlament të kërkojmë të bëhet më shumë për gruan. Gruaja është bërë pjesë në parlament, nuk e di se sa është koeficienti, më duket se 30%, por një pjesë e grupeve parlamentare e kanë të mangët këtë koeficient. Them se në zgjedhjet e ardhshme gruaja do të jetë forcë shtytëse, pse jo të jetë edhe 50% në parlament. Për shembull, Monika dëshironte 50%. Ne duhet ta kthejmë në realitet, jo në slogan. Fjalët duhet t'i bëjmë realitet, sepse flasim shumë dhe bëjmë pak.

Unë ju falënderoj për ftesën dhe për mundësinë për të folur këtu!

E falënderoj UNFPA-në për mbështetjen që ka dhënë vazhdimisht, për të gjithë zhvillimin që i ka dhënë Shqipërisë, që nga fillimi e deri tani. Në sajë të punës së UNFPA-së sëmundjet seksualisht të transmetueshme janë ulur dhe planifikimi familjar ka bërë të mundur që niveli i aborteve të bjerë në minimum. Sot jemi krenarë që për çdo 5,2% të lindjeve, kemi 1 abort. Dikur, për çdo 3 lindje, kishte një abort. Pra, ka qenë shumë i lartë dhe sot abortet janë spontane, nuk janë të planifikuara. Pra, themi që janë bërë hapa shumë të mëdhenj në aspektin e emancipimit të gruas dhe të përfshirjes së saj në shoqëri.

Faleminderit edhe një herë panelit dhe të gjithë pjesëmarrësve për angazhimin tim dhe që mbajta këtë fjalë hapëse sot!

Fiorela Shalsi – Faleminderit, zoti Roshi, për këtë panoramë të gjerë!

Patjetër, përkushtimi juaj tregon se janë vërtet shumë çështje, të cilat janë t'u diskutuar dhe për t'u trajtuar pikërisht që ne të ecim më mirë në indikatorë kyçë për sa i përket barazisë gjinore.

Ju falënderojmë shumë për bashkëpunimin dhe për përkushtimin, që patjetër shpresojmë të jetë edhe në vijim, sidomos në diskutimin e politikave dhe të atyre ndryshimeve që shpresojmë se do të përmirësojnë pikërisht situatën, të cilën po e trajtojmë edhe nëpërmjet prezantimit sot! Dy elemente shumë të veçantë, siç janë plakja e popullsisë dhe ulja e fertilitetit, janë faktorë shumë kyçë dhe duhen marrë vërtet politika urgjente nga qeveria për sa i përket adresimit të këtyre faktorëve që kanë ndikim shumë të madh në popullsinë shqiptare.

Kam kënaqësinë e veçantë që fjalën pasardhëse t'ia jap zonjës Gjermani, e cila është një model shumë i vlerësuar e i dashur në shumë dimensionë për të gjithë, por në mënyrë të veçantë për çështjet e barazisë gjinore është modeli frymëzues për përkushtimin e saj edhe në kohë shumë të vështira, sidomos edhe si dita e sotme. Kështu që ju falënderoj shumë që jeni sot me ne. Fjala është për ju.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit, Fiorela, dhe të gjithë pjesëmarrësve këtu! Përshëndetje, të nderuar kolegë dhe të nderuar pjesëmarrës të panelit!

Në fakt, në këto ditë të fundit të një viti shumë të vështirë të pandemisë diskutojmë për një çështje që na prek të gjithë, gra dhe burra. Merr rendësi të veçantë, sidomos në periudhën e pandemisë, dhe mbase ky vit mund të kërkojë një raport apo një studim më të hollësishëm, balanca e jetës profesionale me atë personale, sepse jam e sigurt që të dhënat e këtij raporti që prezantojmë sot janë të dhëna të bazuara në kushte normale jo në kushte pandemie, sepse besoj se duhet të kenë shumë ndryshime, megjithatë është një çështje që do ta diskutojmë. Kohët e fundit në Shqipëri, siç tha edhe kolegu Roshi, kemi një përmirësim dhe rritje të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Kjo është për t'u vlerësuar, qoftë në parlament, qoftë në qeveri, qoftë në këshillat bashkiakë, qoftë edhe në drejtimin e institucioneve në nivele të ndryshime. E përmend shpesh këtë jo vetëm se është një arritje dhe një tregues i zhvillimit të demokracisë në Shqipëri, por edhe për rolin dhe për impaktin që ato kanë në politikëbërje, në hartimin apo në përmirësimin e legjislacionit, në zbatimin e tij, në modelet që japin edhe për të inspiruar vajza e gra të tjera për të hyrë në politikë dhe në kontributin e qenësishëm për të përmirësuar ligjet dhe politikat në Shqipëri. Sfida e radhës mbetet fuqizimi ekonomik i grave. Pa dyshim aksesin më të madh i grave në tregun e punës, punësimi dhe siguria e tyre në punë, mbështetja e grave sipërmarrëse, aksesin i grave në shërbimet shëndetësore, pra janë duke u përmirësuar të gjitha. Këto janë sfida me të cilat përballet jo vetëm Shqipëria, por edhe shoqëri më të zhvilluara. Meqenëse nga zoti Roshi u përmend një projekt që kemi miratuar marrëveshjen së fundi në parlament, doja ta vlerësoja si një projekt shumë të rëndësishëm të Bankës Botërore me Agjencinë Franceze të Zhvillimit, të cilat i kemi miratuar së fundi në parlament dhe fillojnë të zbatohen dhe kanë fokus kryesor fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave në Shqipëri. Besoj se kjo është e lidhur edhe me temën që po diskutojmë sot dhe do të japë një impakt pozitiv në rritjen e punësimit të grave dhe në rritjen e të ardhurave të tyre.

Çfarë vëmë re?! Vëmë re se në këta vjet është përmirësuar së tepërmi legjislacioni për sa u përket të drejtave të njeriut, të drejtave të grave, si pjesë e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore. Pa dyshim, me të gjitha këto përmirësime ligjesh, vëmë re se pjesëmarrja e grave në jetën publike, por edhe në tregun e punës ka sfida, ka vështirësi që besoj se kanë dalë edhe në raportin që do të paraqitet sot. Ndaj, e vlerësoj disafish raportin që ka përgatitur *IDRA Consulting* dhe UNFPA-në për nismën dhe për mbështetjen e këtij raporti. Mendoj se jemi marrë këto kohë me shumë problematika që prekin shoqërinë shqiptare, gruan shqiptare në përgjithësi, por mbase kësaj çështjeje nuk i kemi dhënë dritën e duhur për ta diskutuar, jo se nuk ka marrë vëmendjen e duhur për sa i përket përmirësimit të ligjeve apo politikave dhe strategjive në Shqipëri. Dua të them se balanca ndërmjet jetës personale dhe profesionale është një sfidë edhe për vendet më të zhvilluara, por jo vetëm për gratë, pa dyshim edhe për burrat.

Një thënie që më vjen ndër mend nga *Ruth Bader Ginsburg*, e cila e ka theksuar këtë gjë për sa i përket barazisë gjinore është: “Gratë mund të arrijnë barazi gjinore me burrat, në qoftë se ndajnë bashkë në mënyrë të drejtë përgjegjësitë për rritjen apo mirërritjen e fëmijëve të tyre dhe brezit të ri”. Pra, është një përgjegjësi e përbashkët që, shpeshherë, për shkak të faktorëve të ndryshëm ekonomikë, socialë, kulturorë ka marrë një konotacion më shumë femëror dhe është parë gjithmonë si përgjegjësi brenda familjes që duhet t’i marrin më shumë gratë apo vajzat dhe më pak burrat. Besoj se kjo është një sfidë e përbashkët dhe theksoj se e përballim, ashtu si edhe shumë shoqëri të tjera shumë më të zhvilluara. Them se janë bërë disa studime të mëparshme nga shoqëria civile për të parë përdorimin e kohës nga gratë e vajzat dhe për të parë edhe përdorimin e kohës nga burrat e djemtë, duke parë diferenca gjinore në mënyrën se si përdoret koha dhe sa të balancuara janë këto, sa kanë mundësi gratë dhe vajzat të marrin pjesë qoftë për arsimimin e tyre, qoftë edhe në tregun e punës apo në jetën publike. Sigurisht, të dhënat apo përfundimet e këtyre studimeve kanë qenë që gratë kanë qenë më shumë të angazhuara në jetën personale, kanë më shumë ngarkesa dhe pritshmëritë ndaj tyre janë shumë të mëdha për t’i përmbushur këto role dhe këto detyra për mirërritjen e fëmijëve, për kujdesin ndaj të moshuarve, për shërbimet kur dikush është i sëmurë e të tjera me radhë, të cilat, sigurisht, kanë ngushtuar hapësirën e grave dhe vajzave për t’u angazhuar në jetën publike, por edhe për t’u punësuar në tregun e punës. Tani flasim në nivel më shumë makro, pra në përgjithësi në shoqërinë shqiptare, se ndonjëherë ngatërrojmë vetëm Tiranën apo vetëm pjesëmarrjen në një sferë të caktuar të grave me të gjithë realitetin shqiptar, që është shumëngjyrësh dhe ka dinamika dhe problematika, të cila duhet t’i adresojmë. Për sa i përket impaktit që mund të kenë, sigurisht, politikën që janë më miqësore, më të përgjegjshme nga ana gjinore, për sa i përket familjes, për çdo shtet garantojnë pjesëmarrje më të ekuilibruar të të dyja gjinive në tregun e punës dhe në jetën publike. Po ashtu, sigurojnë zhvillim më të qëndrueshëm, rrisin dhe motivojnë pjesëmarrjen e të dyja gjinive, duke bërë që kënaqësia dhe sadsifaksioni i këtij zhvillimi të jetë i barabartë për gratë dhe burrat, sepse kemi familje më të shëndetshme, politika më miqësore, qoftë në nivel sipërmarrjeje, edhe në nivel makro; kemi edhe familje më të shëndetshme, fëmijë që rriten duke pasur kontributin e të dy prindërve, të të dy gjinive, që garantojnë inteligjencë më të mirë, një mirërritje dhe një edukim më të mirë.

E theksoj se gjërat që po diskutojmë, që do të prezantohen sot nga raporti, janë para pandemisë. Mendoni që në periudhën e pandemisë ekuilibrat sërish janë prishur. Kam frikë se, nga studimet që kam lexuar, qoftë edhe në Shqipëri, janë në disfavor të grave.

Fakti që lokdauni apo periudha më pas ka krijuar çrregullime në faktin e punësimit, duke punuar nga shtëpia, fëmijët duke mësuar nga shtëpia, apo kujdesi për të sëmurët, ka rritur

ngarkesën e grave dhe vajzave brenda familjes, duke çekuilibruar këtë lloj balance që jemi munduar ta krijojmë prej vitesh.

Për sa u përket përmirësimeve ligjore ndër vite, apo se si janë ligjet në Shqipëri, që adresojnë këtë problem, jam e sigurt që janë në raport, por unë do të doja t'i përmendja. Fillon nga Kushtetuta e Shqipërisë, vazhdon me ligjin "Për Sigurimet Shoqërore", me Kodin e Punës, ligjet: "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", "Për barazinë gjinore", "Për mbrojtjen nga diskriminimi", "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", "Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara", "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", "Për strehimin social". "Për nxitjen e punësimit", "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", dhe pa dyshim, ka disa VKM: strategjia e barazisë gjinore, strategjia e punësimit dhe përfshirjes sociale, të cilat, në një mënyrë apo tjetër, adresojnë balancën që duam të krijojmë mes jetës personale dhe asaj profesionale, si dhe politikave më miqësore.

E theksoj se të gjitha ligjet që përmenda janë hartuar apo përmirësuar ndër vite.

Sërish dua të theksoj se këto vitet e fundit, një pjesë e mirë e këtyre ligjeve janë përmirësuar duke i bërë më të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, duke vlerësuar edhe kontributin e grave, zonjave që janë pjesë e parlamentit, pa dyshim, në bashkëpunim me kolegët, por dua të theksoj në mënyrë të veçantë rolin e tyre për këto përmirësime ligjore.

Çfarë ndodh? Në realitet, sigurisht, kemi vështirësi për hir të mentalitetit, për hir të kohës shumë të kufizuar që kanë gratë për t'u angazhuar me jetën publike dhe në jetën profesionale, edhe për faktin që nëse janë të angazhuar në këtë jetë publike, ky emancipim dhe kjo pjesëmarrje jo gjithmonë është shoqëruar me faktin që brenda familjes këto ekuilibra janë rikrijuar.

E theksoj që kemi modele pozitive, që përmes mbështetjeve ligjore, mbështetjeve të politikave dhe institucionale, janë bërë ndryshime të qenësishme. Mendoj se ajo që kemi më shumë sfida para vetes është të rrisim mbështetjen përmes shërbimeve sociale, shëndetësore, shërbimeve të mirërritjes dhe kujdesit për fëmijët dhe për të moshuarit, që kjo barrë apo ngarkesë, që pritet të luhet nga gratë, të lehtësohet, që ato të kenë më shumë hapësirë për t'u zhvilluar profesionalisht dhe për të kontribuar në zhvillimin profesional të vendit.

Unë nuk dua të zgjatem, sepse dua të dëgjoj të dhënat dhe gjetjet e raportit. Pa dyshim, e shikoj këtë moment të lancimit të këtij raporti si një pikë reflektimi për të gjithë ne, duke parë çfarë është bërë deri tani, ku kemi arritur me përmirësimin e legjislationit, që shpesh herë është i krahasueshëm me vendet e Bashkimit Europian, çfarë kemi nevojë për të përmirësuar në këtë legjislation. U shpreh edhe kryetari i Komisionit të Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë.

Mendoj se kemi vullnetin politik dhe angazhimin e të gjithë parlamentit, pa dyshim, edhe timin, si kryetare e Nënkomisionit të Barazisë Gjinore dhe Aleancës së Grave Deputete. Jemi gjithë sy dhe veshë për të dëgjuar nëse kemi nevojë të bëjmë përmirësime të tjera në ligj. Nëse po, t'i bëjmë. Kemi nevojë të dëgjojmë më shumë perspektivën se si po zbatohet ligji në praktikë dhe çfarë vështirësish ka aty. Atëherë, ne duhet të sforcojmë më shumë komponentin e monitorimit të zbatimit të legjislacionit, dhe nëse vërtetë praktika dhe modele të reja, që janë nga vendet e rajonit, apo nga vende më të zhvilluara, mund t'i aplikojmë në Shqipëri, pse jo!

Unë thjesht doja të thosha se ka modele, qoftë nga institucioni shtetëror, që ndoshta janë më të pakta, të zhvillimit të sipërmarrjes në Shqipëri, që kanë krijuar kushte më të mira për nënat me fëmijë, duke pasur kopshte pranë institucioneve të tyre, duke krijuar më shumë lehtësi për të bërë një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore brenda atyre institucioneve, për të krijuar një balancë më të mirë të grave dhe burave në familje dhe në shoqëri dhe mendoj se rritet motivimi në punë dhe efikasiteti i tyre.

Këto praktika të mira mund t'i kemi dhe i kemi edhe brenda realitetit shqiptar. Ndoshta duhet t'i bëjmë më shumë vizibël, t'i shikojmë më shumë dhe të përpiqemi t'i plotësojmë apo t'i përdorim edhe në realitete të tjera në nivel vendor apo qendror.

Angazhimi është këtu. Pa dyshim, jam e interesuar të dëgjoj me më shumë detaje raportin dhe kolegët e mi. Them se UNFPA-ja me këtë raport jep një kontribut tjetër për sa i përket arritjes së barazisë gjinore. Titulli më pëlqen shumë "Më shumë zgjedhje" për analizat e politikave të përgjegjshme gjinore. Unë i konsideroj miqësore ndaj familjes. Titulli "Më shumë zgjedhje" për mua do të thotë shumë. Kemi nevojë për më shumë zgjedhje dhe jemi të angazhuar për t'i bërë ato.

Faleminderit dhe suksese!

Fiorela Shalsi – Faleminderit, si gjithmonë, për panoramën shumë të saktë dhe të gjerë!

Absolutisht, synimi i analizës është studimi i situatës. Në bazë të studimeve të mëparshme, pikërisht legjislacionit ekzistues, të dhënat që merren nga institucionet e ndryshme, ne duam të kuptojmë me një panoramë të përgjithshme se ku jemi dhe ne shpresojmë shumë që kjo të na japë një moment reflektimi që të shohim pikërisht elementet, qoftë për politika të reja, qoftë për të forcuar zbatimin e ligjit, sepse ne e dimë se puna juaj është e jashtëzakonshme, por, ndërkohë, zbatimi në Shqipëri gjithmonë mbetet prapa dhe këtu mund të gjejmë mekanizma që mund t'i përforcojmë më shumë.

Projekti ka tre komponentë; bashkëpunimin me qeverinë dhe institucionet legjislative për përmirësimin e politikave dhe vendimeve, me biznesin privat për të ndihmuar krijimin e mjediseve më miqësore për sa i përket familjes, pra punonjësit të kenë një ambient në punë më

miqësor për u përket përgjegjësi të tyre midis ndarjes së jetës personale dhe jetës profesionale dhe një komponent që është shumë i rëndësishëm, në të cilin kanë rol të gjithë, është komponenti social, ku secili prej nesh mund të kontribuojë për të thyer pikërisht stereotipet apo ato sjellje, të cilat i përforcojnë problematikat që ju evidentuat dhe që ne shpresojmë shumë që të evidentohen edhe më shumë nëpërmjet të dhënave që do të ndajmë nëpërmjet analizës.

Para se t'u jap fjalën kolegeve të mia shumë të dashura, do t'ju lutesha shumë për 1 minutë të ndizni kamerat për një foto, duke qenë se kjo është mundësia që na jep ky lloj komunikimi hibrid në sallë dhe online. Nëse do të kishim mundësi t'ju kemi në kamera, do ta vlerësonim shumë.

Ndërkohë që IT-ja po përgatitet, ju falënderojmë shumë të gjithëve!

Vijojmë me pjesën e dytë, që është shumë e rëndësishme. Analiza është përgatitur nga skuadra e IDR-ës, me të cilën ne kemi punuar shumë ngushtë me dy kolege shumë të dashura, Blerina Metani dhe zonjën Blerta Kolavaçe.

Pjesa e parë është një analizë ligjore, të cilën do ta ndajë me ne zonja Blerta dhe më pas do të kemi edhe komentet tuaja paraprake, në mënyrë që të mos jemi vetëm ne që flasim. Në fazën e dytë do të kemi diskutimin mbi të dhënat, kurse faza e parë do të përqendrohet në analizën ligjore dhe disa gjetje që janë bërë.

Kam kënaqësinë të ftoj zonjën Blerta.

Blerta Kolavaçe – Faleminderit, Fiorela!

Falënderoj të gjithë pjesëmarrësit!

Falënderoj përfaqësuesit e Kuvendit, zonjën Eglantina dhe zotin Enver!

Sikundër zonja Gjermani e përmendi kuadrin ligjor shqiptar, që rregullon politikat mjekësore për familjen, ai është një legjislacion që rregullon më së miri, deri diku, çështjet miqësore për familjen.

Analiza, faktikisht, është përqendruar duke u ndarë dhe rregulluar në tre aspekte kryesore: rregullimet për çështjet e lejeve, rregullimet financiare dhe rregullimet për çështjet e punës.

Kuadri ligjor shqiptar që rregullon çështjet e lejes së lindjes është Kodi i Punës dhe ligji “Për sigurimet shoqërore”. Bazuar në legjislacionin shqiptar, prindërit në Shqipëri kanë të drejtë të marrin leje prindërore, leje lindjeje nëna, leje lindjeje babai dhe leje për përkujdesjen ndaj fëmijës.

Leja prindërore është një koncept i prezantuar me amendimet që Kodi i Punës ka pësuar në vitin 2015.

Kohëzgjatja e lejes prindërore është katër muaj. Leja jepet e ndarë, por jo më pak se një javë në vit. Secili nga prindërit mund ta kërkojë lejen prindërore individualisht dhe është një lejë që mund të transferohet nga njëri prind tek tjetri. Leja prindërore momentalisht është e papaguar dhe nuk mund të transferohet. I njëjti rregull ndiqet edhe për fëmijën e birësuar. Pra, rregullimi që legjislacioni shqiptar bën për lejen prindërore është një e drejtë që i jepet secilit nga prindërit që të marrë 4 muaj të papaguar derisa fëmija të mbushë moshën 6 vjeç.

Leja e lindjes për nënën, në gjykimin tim personal si juriste, është një leje e mirërregulluar në legjislacionin shqiptar. Leja e lindjes rregullohet si nga Kodi i Punës, ashtu edhe nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore. Kohëzgjatja e lejes së lindjes për një grua në Shqipëri është 365 ditë kalendarike me një minimum prej 35 ditësh përpara datës së lindjes dhe 63 ditë pas datës së lindjes. Është një periudhë kohe që Kodi i Punës e rregullon; do ta shikojmë edhe te rregullimet e çështjeve të punës më vonë që gruaja shtatzënë apo nëna e re ndalohet të punësohet gjatë kësaj periudhe.

Për gruan shtatzënë me më shumë se një fëmijë periudha e përfitimit rritet. Do ta shikojmë që këtë e kemi shumë të ngjashme edhe me praktikën e mira.

Në rastin e birësimit periudha e lindjes ka një kohëzgjatje prej 330 ditësh dhe minimumi është 28 ditë. Të ardhurat apo mbulimi financiar për lejen e lindjes nuk paguhet nga punëdhënësi, por nga skema e sigurimeve shoqërore.

Mënyra sesi paguhet apo si mbulohet leja e lindjes në faqen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore është një përlllogaritje shumë e saktë, me disa shembuj specifikë që bëhet llogaritja. Ajo që ne kemi shkëputur është thjesht 150 ditët e para, plus 35 ditët e paralindjes, paguhet me 30% të mesatares të vlerësuar neto të 12 pagave të fundit. Pjesa tjetër e mbetur e ditëve, 150 ditët e fundit, paguhet me 50%. Kushti që ka legjislatori shqiptar vendosur që gratë të përfitojnë nga të ardhurat e lejes së lindje është që duhet të kenë derdhur të paktën 12 muaj kontribute për çdo fëmijë. Përfshihen nga ky rregull vetëm rastet kur shtatzënia e radhës është brenda 24 muajve nga data e fillimit të paralindjes.

Leja e lindjes për babanë apo për burrat është një leje, e cila është rregulluar si nga Kodi i Punës, ashtu edhe nga ligji “Për sigurimet shoqërore”. Baballarët në momentin e lindjes së fëmijës kanë të drejtë të marrin 3 ditë leje të paguara. Kjo mbulohet nga punëdhënësi. Baballarët pas ditës 63-të të lindjes së fëmijës mund të marrin lejen e lindjes për t’u kujdesur. Amendimet e ligjit “Për sigurimet shoqërore”, që rregullojnë lejen e lindjes për nënën, kanë parashikuar një dispozitë që thotë të drejtën e kanë edhe baballarët e siguruar pas ditës së 63-të. I njëjti rregull aplikohet edhe për babanë birësues. Kohëzgjatja e lejes së lindjes është 267 ditë. Kjo për arsye se burrat nuk përfitojnë periudhën e paralindjes dhe 63 ditët pas lindjes.

Mënyra e pagesës për analogji është e njëjtë me mënyrën sesi mbulohet financiarisht edhe leja e lindjes për nënën.

Leja e fundit që rregullon legjislacioni shqiptar, është leja për përkujdesjen ndaj fëmijës. Sipas rregullimeve dhe dispozitave të veçanta që Kodi Punës bën në rastin e përkujdesit të domosdoshëm për fëmijët në ngarkim, prindërit kanë të drejtën e 12 ditëve leje të paguar në vit. Prindërit më fëmijë deri në 3 vjeç kanë të drejtën e një pushimi të paguar deri në 15 ditë, kur fëmija është i sëmurë, vërtetuar kjo gjë me një raport mjekësor. Përmendim këtu që këto ditë pushimi janë të mbuluara nga punëdhënësi dhe aplikohen njëjloj si për sektorin privat, ashtu edhe për atë publik.

Leja i jepet prindit që kujdeset në mënyrë më efektive për fëmijën dhe, në rast të kundërt, ajo jepet me radhë si nënës edhe babait. Përveç ditëve të paguara, prindërit kanë të drejtën e një lejeje shtesë jo më shumë se 30 ditë në vit pa pagesë.

Për sa u përket rregullimeve financiare, kuadri ligjor dhe rregullator shqiptar ka parashikuar disa gjëra, sikurse e përmendëm, përfitimi financiar i lindjeve mbulohet kryesisht nga skema e sigurimeve shoqërore dhe krahas tyre nuk ka rregullime të veçanta.

Ligji “Për sigurimet shoqërore” ka një dispozitë të veçantë që rregullon shpërblimin për lindjen e fëmijës, është një shpërblim që jepet vetëm një herë, kusht është që nëna ose babai të jenë të siguruar. Prioritet në marrjen e këtij shpërblimi ka nëna. Shpërblimi është i barabartë me 50% të pagës minimale që, nëse i referohemi vendimit të Këshillit të Ministrave në fuqi, i cili rregullon pagën minimale aktualisht, do të jetë 13 mijë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ajo është VKM-ja në momentin që lindin për një fëmijë, 800 mijë lekë për dy fëmijë.

Për sa u përket rregullimeve financiare për ushqyerjen e fëmijëve me gji Kodi i Punës ka dispozita të veçanta që rregullojnë të drejtën e një nëne për ushqyerjen me gji të fëmijës së saj. Një nënë ka të drejtë në momentin që kthehet në punë pas ditës së 63-të të zgjedhë në marrëveshje me punëdhënësin e saj nëse do një pushim të paguar prej 2 orësh në orarin normal të punës ose një orar pune të shkurtër me 2 orë me të njëjtën pagë si orari normal.

Përveç lejeve të paguara për përkujdesjen ndaj fëmijës nuk ka rregullime të tjera financiare që mbështesin prindërit për përkujdesjen ndaj fëmijës.

Aksesi për përkujdesin ndaj fëmijës apo qasja për përkujdesin ndaj fëmijës, përfshijmë këtu kopshtet, çerdhet dhe sistemin e shkollave; është një sistem që nuk ka rregullime specifike për sa i përket mbështetjes për prindërit në marrëdhënie pune. Përmendim që sistemi i kopshteve, i çerdheve dhe i shkollave është një sistem që rregullohet dhe është në menaxhimin

e njësisive të vetëqeverisjes vendore. Tarifat vendosen me vendim të këshillit bashkiak dhe janë tarifa minimale që kryesisht mbulojnë kostot e ushqimit.

Nëse do të ndalemi në rregullimet për çështjet e punës, dispozitat e Kodit të Punës janë të mirërregulluara për sa i përket mbrojtjes që u bëhet nënave të reja dhe grave shtatzëna për sa u përket kushteve të punës, mbrojtjes së shëndetit, mbrojtjes së pozicionit të punës apo kontratën e punës.

Sipas Kodit të Punës, është e ndaluar kryerja e orëve shtesë të punës nga gratë shtatzëna pas lindjes së fëmijës derisa fëmija të mbushë moshën 1 vjeç. Gratë shtatzëna janë të ndaluara të punojnë 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes, kjo është periudha që është dhe leja e detyruar e lindjes për gruan. Kur gruaja është shtatzënë me më shumë se me një fëmijë, periudha e parë bëhet 60 ditë.

Një rregullim tjetër është fakti që gratë shtatzëna ose me fëmijë në gji nuk mund të punësohen me punë të rënda ose të rrezikshme që dëmtojnë shëndetin e të fëmijës.

Një të drejtë që ka gruaja, e cila sapo ka lindur, pas periudhës gjashtëdhjetetreditore, është e drejta për t'u kthyer në punë, dhe është një e drejtë vendos vetë ajo nëse dëshiron të kthehet në punë apo të përfitojë nga skema e sigurimeve shoqërore. Nëse vendos të kthehet në punë pas ditës së gjashtëdhjetetretë, por vendi i mëparshëm i punës nuk plotëson kushtet për mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit, punëdhënësi është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i siguruar asaj përshtatjen e përkohshme të kushteve të punës dhe të orëve të punës.

Rregullimet e tjera janë rregullime që mbrojnë pozicionin e punës dhe zgjidhjen e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit. Kjo do të thotë se me mbarimin e lejes së lindjes, si në rastin kur e përfiton gruaja, si në rastin kur e përfiton burri, punëmarrësi ka të drejtë të kthehet në të njëjtin vend pune, me të njëjtat kushte.

I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin e birësimit, kur prindërit përfitojnë nga leja e birësimit. Gjithashtu, Kodi i Punës rregullon në mënyrë të shprehur, që është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës, kur njoftohet nga punëdhënësi, gjatë periudhës kur punëmarrësi ka përfituar lejen e lindjes. I njëjti rregull aplikohet edhe në rastin e birësimit.

Një rregullim tjetër që bën Kodi i Punës për sa i përket kushteve fleksibël të punës, është rregullimi dhe përkufizimi i telepunës apo i punës nga shtëpia, gjë që do të thotë se u jep të drejtën punëdhënësve dhe punëmarrësve, që në marrëveshje me njëri-tjetrin të përcaktojnë edhe kushtet e telepunës apo të punës nga shtëpia.

Tani, nëse nuk ka ndonjë pyetje...

Fiorela Shalsi – Po. Atëherë, shumë faleminderit për pjesën e parë të prezantimit, në fakt të studimit. Ne jemi në dijëni se audiencia që kemi sot është shumë miks. Shumë prej pjesëmarrësve këtu, janë ata që kanë marrë vendimet në lidhje me këto rregullime ligjore, dhe ne kërkojmë ndjesë për përsëritjen. Megjithatë ndonjëherë, jo gjithmonë, është gjë e mirë edhe përsëritja e detajeve, por duke qenë se audiencia e sotme është miks, ndonëse shumë prej të ftuarve e kanë këtë lloj informacioni, jo të gjithë, prezantimi u bë pak më i zgjeruar.

Kësisoj, nëse nga pjesëmarrësit ka ndonjë pyetje specifike, komente, sugjerime, rekomandime, vlerësime e çfarëdolloj komenti në lidhje me atë që është zhvilluar deri në këtë moment, të gjithë janë të ftuar të flasin. Për gjithçka, edhe për pjesën e parë të diskutimeve, edhe për pjesën e parë të prezantimit, jeni të hapur për komente.

Enver Roshi – Bëni prezantimin të dyja, e pastaj bëni lidhjen e anës ligjore me anën e gjetjeve...

Fiorela Shalsi – E të të dhënave. Atëherë, sugjerimi nga ana e panelit është që të dëgjojmë edhe pjesën e dytë të studimit, që ka të bëjë me gjetjet kryesore të analizës.

Faleminderit!

Blerina Metanj – Faleminderit, Fiorela!

Analiza e të dhënave është shtylla e dytë e këtij raporti, dhe le të themi, frymëzimi për të pasur një analizë të dhënash bazohet mbi atë që është e vështirë të adresosh diçka që ti nuk e shikon. Prandaj, qëllimi i analizës së të dhënave është të nxjerrë në pah atë që ekziston. Kjo është sfida e parë.

Sfida e dytë është të zgjedhim treguesit, sepse mund të ketë një gamë të jashtëzakonshme treguesish, por nuk duhet të humbim në të dhëna. Duhet të jemi të targetuar, duhet të jemi të fokusuar në lidhje me atë çfarë duhet të arrijmë, atë që edhe zonja Eglantina e ka përmendur me termin “politika miqësore” për familjen. Pra politikat miqësore për familjen, në radhë të parë duhet t’i japin gruas dhe burrit mundësinë të përmbushen në familje, duke pasur parasysh se përmbushja në familje lidhet me lindshmërinë. Kjo do të jetë shtylla e parë e analizës së të dhënave. Pjesa tjetër është që ato të përmbushen në lidhje me punësimin.

Ky do të jetë edhe fokusi i analizës së të dhënave, që do të prezantohet. Siç e thashë, fillon me një analizë jo vetëm të nivelit aktual, por edhe të tendencës së lindshmërisë në Shqipëri: si lidhet kjo me arsimin, pra, duke e njohur arsimin si një element kyç që ndikon në lindshmërinë të gratë; si paraqitet situata në kohën e shpenzuar për punë të paguar dhe për punë të papaguar; si paguhen tashmë në punë, gratë dhe burrat, a ka hendek, sa është.

Patjetër, jemi munduar të fusim si element të analizës edhe ndikimin e pandemisë në këto dy gjini në lidhje me sferat e lindshmërisë e të punësimit.

Shqipëria po përjeton jo vetëm rënie të lindshmërisë, por ajo që duhet theksuar, është edhe fakti se trendi i dhjetë vjetëve të fundit ka qenë vetëm në rënie. Pra, viti i fundit që Shqipëria ka pasur një nivel mbi nivelin e zëvendësimit, dhe me nivel të zëvendësimit duhet të kuptohet nivelin në të cilin çifti arrin të riprodhojë veten e tij, ka qenë viti 2001. Mbas atij viti ka pasur disa luhataje, por dhjetë vjetët e fundit jo vetëm që niveli është 1, 36, pra më i ulët se mesatarja në Europë, duhet thënë se dhjetë vjetët e fundit ky nivel ka njohur vetëm rënie.

Ndërkohë, nga ana tjetër, mesatarja në Europë është 1, 55, por duket se Europa ka arritur një lloj stabiliteti në lidhje me këtë lindshmëri, e cila mbetet sërish e ulët, sepse vazhdojmë të flasim për një nivel më të ulët se niveli i zëvendësimit.

ADHS-ja ose Studimi Demokratik dhe Shëndetësor në Shqipëri është një vlerë e shtuar, sepse krahas nivelit aktual të lindshmërisë, që ne na e siguron Gjendja Civile, na tregon si është kërkesa, nëse flasim me terma tregu, si është preferenca e grave për fëmijët, pra cili është numri ideal, që ato do të donin të kishin? E kur flitet për numër ideal, ti abstragon në lidhje me kushtet ekonomike e sociale, të cilat mund të të pengojnë ta arrish atë numër ideal.

Në 2008-ën numri aktual ka qenë 1, 6 nga burimet administrative, ndërkohë, sipas anketës, numri ideal ka qenë 2, 6. Shohim që këto dy tregues, gjatë këtij dhjetëvjeçari: 2008-2018, duke pasur si bazë vitet e zhvillimit të anketës demografike dhe shëndetësore, kanë njohur rënie. Të dyja kanë rënie. Pra, gratë jo vetëm që po ulin lindshmërinë, por kanë ulur edhe preferencat ose kërkesën për lindshmëri. Ndërkohë, hendeku midis këtyre treguesve është një fëmijë.

Cili është ndikimi i arsimit në lindshmëri në vendin tonë? ADHS-ja tregon një lidhje shumë të bukur, pasi burimet administrative nuk na e mundësojnë këtë lloj analize, që për çdo nivel të arritur, gratë e shtyn lindjen e fëmijës së parë me një vit. Pra, në qoftë se mesatarja e moshës së lindjes së fëmijës së parë për gratë pa arsim është 21-22 vjeç dhe për gratë me arsim të detyruar është 22-23 vjeç kjo moshë gjithmonë shtyhet. Është e bukur lidhja, sepse për çdo nivel shtyhet pothuajse me një vit mosha e lindjes së fëmijës së parë. Arsimi jo vetëm që shtyn lindshmërinë e grave në Shqipëri, por çuditërisht, nëse ne e analizojmë nivelin e lindshmërisë së grave sipas arsimit të tyre dhe nivelin e dëshiruar të fëmijëve për nivelin universitar, duket që arsimi ka një rol të drejtpërdrejtë. Duket që ka një përputhje të lindshmërisë së dëshiruar me lindshmërinë aktuale. Kjo do të thotë, në terma të thjeshtë, se nuk kemi shtatëzani të padëshiruar për gratë me arsim të lartë, ndërkohë që duket se ka diferenca për gratë me arsim më të ulët se ai universitar.

“Përdorimin i kohës”. Ky grafik ka abstarguar nga koha e shpenzuar për gjumë dhe koha për aktivitete personale. E gjitha koha, 100%, përbën vetëm punën e paguar dhe punën e

papaguar. Në qoftë se ne do ta konceptojmë ditën vetëm të shpenzuar për këto dy aktivitete gratë do të shpenzonin gjysmën e ditës për aktivitete të papaguara në Shqipëri. kjo është sipas studimit të bërë në vitin 2010 të përdorimit të kohës. Ndërkohë burrat do të shpenzonin 1/5 e kohës së tyre për aktivitete të papaguara.

“Pabarazia fillon në shtëpi”. Qëllimi i këtij *slide* është të evidentojë që pjesëmarrja e pabarabartë në aktivitete të papaguar fillon që në fëmijëri. Pra, po të shikoni, 30% e djemve, 10-14 vjeç., angazhohen në punë të papaguara, ndërkohë, nga ana tjetër, kemi 67% të vajzave që angazhohen në punë të papaguara. Kjo tregon se kultura jonë i përfshin vajzat, ndoshta në mënyrë intuitive, pa e vënë re, më shumë në aktivitete të papaguara sesa djemtë. Patjetër që kjo diferencë theksohet për një grupmoshë 15-49 vjeç, që është më aktive në tregun e punës, dhe duket që burrat pas moshës së pensionit fillonë të angazhohen më shumë, ku kemi 63% të përfshirjes së tyre në aktivitete të papaguara, por që diferenca midis gjinive është e ndjeshme.

Për të dalë nga ngërçi që na jep anketa e përdorimit të kohës, të cilën unë e theksoj edhe te sfidat, sepse është një anketë e vjetër, e vitit 2010 (edhe pse anketa të tilla rekomandohen të bëhen jo shpesh, sepse janë disa sjellje që nuk janë dinamike në kohë, pra, duan kohë që të japin impakt për të matur ndryshimet), ne kemi përdorur një anketë tjetër të Eurofondit të vitit 2016, i cili ka edhe një anketë të vitit 2020 të quajtur “Cilësia e jetës”, por që të dhënat nuk janë ende në dispozicion. Edhe në këtë anketë që ne kemi përdorur duket se ka një diferencë të theksuar në aktivitete të përkujdesjes së shtëpisë, si gatimi dhe pastrimi, ku kemi 16% të burrave kundrejt 88% të grave në përfshirjen e këtyre aktiviteteve, dhe në aktivitetet e edukimit të fëmijëve, ose përkujdesjes së moshës së tretë, ku vetëm ¼ e burrave janë përfshirë në aktivitete të tilla, ndërkohë që kemi gjysmën e grave të përfshira në këto aktivitete.

Për të thënë që këto lloj aktivitete mund të shkaktojnë një pjesëmarrje më të ulët të grave në tregun e punës, patjetër që duket se ka një lidhje të zhdrejtë, sepse, sipas anketimit të vitit 2016, kemi 65% të burrave kundrejt gjysmës së grave. Është e vërtetë që gjysma e grave merr pjesë në punë, por po të shikojmë të dhënat e INSTAT-it, në 10 vjetët e fundit pjesëmarrja e grave në arsimin e lartë është më e lartë sesa e djemve. Pra, ka një ngërç që gratë i frenojnë të marrin pjesë në tregun e punës. Përdorimi i kohës ndalet në tranzicionin e bërjes prind.

Si e shpenzojnë burrat kohën kur nuk janë pa angazhime, duke e quajtur angazhimin pasjen e një fëmije të vogël?! 37 minutat në një ditë tipike, pa futur fundjavat, ata i shpenzojnë në aktivitete të papaguar, por ndërkohë që bëhen prindër angazhimi rritet dhe shkon diku të 60 minuta.

Çfarë ndodhë me gratë? Gratë, 5 orë, të cilat i shpenzojnë për aktivitete të papaguara edhe kur janë pa fëmijë, në momentin që bëhen me fëmijë koha shkon në 8 orë e 25 minuta. Në 24 orë kjo është barrë ose një rëndesë goxha e madhe që bie mbi shpatullat e tyre.

Ne nuk kemi një studim të mirëfilltë në Shqipëri që të bëjmë një lidhje të drejtpërdrejtë që lindshmëria na impakton pjesëmarrjen në punësim, prandaj, duam apo nuk duam, ne duhet t'i biem rrotull për të thënë që ka një lidhje dhe ky grafik synon të tregojë këtë lidhje.

Çfarë tregon grafiku?! Grafiku tregon që 64% e lindjeve në vendin tonë ndodhin në moshën 15-29 vjeç. Të dhënat e INSTAT-it tregojnë që pas moshës 30 vjeç niveli i lindshmërisë specifik sipas grupmoshave bie dhe pjesëmarrja e tyre është vetëm 49 % në tregun e punës. Çfarë ndodhë pas moshës 30 vjeç, ku kemi më pak lindje, 1 në 3 gra lind, 36% e lindjeve ndodhin në këtë grupmoshë?! Aty pjesëmarrja në tregun e punës dyfishohet. Pra, nuk mund të themi që nuk ekziston një lidhje midis momentit të bërjes prind dhe pjesëmarrjes në tregun e punës.

Çfarë thonë vetë gratë?! Anketa LFS, ose anketa e forcës së punës, i pyet gratë që janë të papuna për arsye të tjera se ato janë jashtë punësimit. Gratë thonë vetë, e pyetur popullsia 15+, që 18% e tyre janë jashtë tregut të punës për shkak të përgjegjësive familjare, kundrejt vetëm 1% të burrave. Ndërkohë, poshtë është vënë një zinxhir shumë i rëndësishëm, pra pjesa e të rinjve, që rrinë jashtë tregut të punës për arsye të përgjegjësive familjare, por jo vetëm jashtë tregut të punës, por edhe jashtë shkollimit. Të pyetur sërish në anketë, ora vetëm ky targetgrup, këta të rinj, 32% e vajzave thonë se rrinë jashtë tregut të punës ose jashtë shkollimit për shkak të përgjegjësive familjare kundrejt vetëm 2% të djemve. Pra, e thonë vetë ata, është një vetëdeklarim i tyre i bërë në anketën e forcave të punës.

Ky slide del nga pjesëmarrja dhe futet në punësim, pra gratë dhe burrat u punësuan. INSTAT-i rishtazi në nëntor ka nxjerrë anketën strukturore të të ardhurave, ku mund të masim hendekun gjinor sipas standardeve europiane, pra ta bëjmë të krahasueshëm, sepse deri dje e masnim me rekordet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pra burim administrativ, gjë që nuk na e bënte të lejueshme që ta masnim edhe me vendet e tjera. Tashmë kjo anketa na e lejon. Sipas kësaj ankete, gratë paguhen 93% të rrogës së burrave për të njëjtin pozicion, pra ka 7% diferencë.

Çfarë është vënë re?! Është vënë re se profesionet më të mirëpaguara, si menaxherë, kanë më pak hendek gjinor, por kanë një pjesëmarrje më të ulët të grave. Pra, duket që ka diskriminim në profesionet më pak të paguara, ku mund të aludojmë dhe mund të supozojmë që edhe niveli arsimor që ata kërkojnë, është më i ulët për gratë.

Për të pasur një analizë të plotë dhe për të qenë pak provokativë, kemi marrë edhe pensionet. Absolutisht që pensionet reflektojnë strukturë e një tregu të ngritur pune. Domethënë, janë thjesht pasojë. Megjithatë, është interesante të shikojmë se çfarë ndodh me gratë dhe burrat në momentin që ato kanë “shpëtuar” nga detyrimet familjare?! Gratë paguhen ose marrin pension mesatarisht 20% më pak se sa burrat në vend. Ashtu siç e tha edhe zoti Enver, kanë një jetëgjatësi më të lartë. Pra, sistemi detyrohet t’i mbajë më gjatë, edhe pse me pensione më të ulëta. Ndërkohë INSTAT-i ka nxjerrë atë që quhet “*Gender equality index*” në janar dhe ai jep një tregues shumë interesantë, që është jetëgjatësia e shëndetshme. Edhe pse gratë jetojnë më gjatë, ato jetojnë në cilësi jete më të ulët. Pra, është e rëndësishme që ne këtu ta vëmë theksin edhe te mosha e tretë.

Së fundi, të mundohemi të marrim parasysh se çfarë ka ndodhur jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën vitin e fundit. Sipas një vlerësimi të shpejtë që ka bërë IDRA me *UN Women*, më shumë burra deklarojnë se kanë humbur punën, pra 17% kundrejt 12%. Gratë kanë më shumë fleksibilitet të punojnë nga shtëpia 51%, kundrejt 27% të burrave. Ashtu siç mund ta shikoni, kjo nuk është reflektuar, ose angazhimi i tyre në përgjegjësitë familjare, nuk është reflektuar në të njëjtën mënyrë. Gratë marrin më shumë pjesë në aktivitete të papaguara 70% ose përkujdesje për fëmijët, kundrejt 50% të burrave dhe, duke qenë përballë burrave, që kanë humbur më shumë punë, ato janë të detyruara të rrinë më shumë në shtëpi, të përkujdesen më shumë për fëmijët, patjetër që edhe përjetimi i stresit apo i ankthit është i përkthyer në përqindje më të larta te gratë se sa te burrat.

Fiorela Shalsi – Shumë faleminderit, Blerina, për prezantimin, pikërisht për statistikat, që besoj se flasin vetë, ashtu sikurse edhe për analizën e detajuar që keni bërë pikërisht për të sjellë ato statistika që shpresojmë që flasin pikërisht për dizbalancat që ekzistojnë midis dy sferave, pra jetës personale dhe profesionale. Në fakt, dua që prezantimin ta ndërpresim këtu. Prezantimi ka edhe dy pjesë të tjera. Për arsye të kohës, duke qenë se nuk duam t’ju marrim më shumë kohë, për pjesën e praktikave të mira raporti është ndarë në tri materiale, të cilat do të shpresojmë që do t’i ndajmë, edhe pse jemi *online*, por edhe nëpërmjet *facebook*-ut apo edhe nëpërmjet medimeve të tjera *online*, por i kemi edhe të printuara dhe shpresojmë që të gjithë pjesëmarrësit do të marrin një paketë të plotë bashkë me raportin dhe me të dhënat specifike. Kështu që për të kursyer kohë nuk do ta kryejmë “Praktikat më të mira”, sepse është një material që mund ta lexoni, nëse jeni të interesuar, për të parë se çfarë ndodh në vende të tjera. Ne jemi munduar të zgjedhim vende të rajonit, por edhe më gjerë për të parë se cilat janë praktikat që mund t’i përshtatim në Shqipëri për të përmirësuar pikërisht kuadrin ligjor apo edhe forma specifike që mund të ndiqen nga biznesi privat.

Në fund të prezantimit janë vetëm rekomandimet, që, në fakt, dua t'i shfaqim në një moment të dytë, pasi jemi shumë të interesuar të dëgjojmë komentet, përshtypjet, vlerësimet apo sugjerime që kemi nga pjesëmarrësit *online*.

Ju falënderoj shumë për durimin, sepse ishin shumë folës dhe sigurisht që është pak ndryshe kur jemi *online*. Kështu që unë do të vlerësoj shumë nëse ka komente qoftë nga paneli apo nga pjesëmarrësit *online* në raport me çfarë dëgjuat deri tani. Kështu që është fjala për ju.

Faleminderit!

Nëse keni pyetje, çfarëdolloj gjeje është e hapur për ju.

Vjollca Koko – A mund të flas?

Fiorela Shalsi – Më duket, nuk e keni hapur mikrofonin, sepse dëgjoheni që po flisni.

Zonja Vjollca, ju lutem, hapni mikrofonin!

Vjollca Koko – Faleminderit që më bëtë pjesë për ta dëgjuar këtë aktivitet!

Të përsëritës, Fjor, sepse...

Fiorela Shalsi - Zonja Vjollca, a më dëgjoni?

Nuk e keni mikrofonin të hapur dhe nuk ju dëgjojmë.

Vjollca Koko – E kam të hapur mikrofonin, sepse ajo zonja më thotë se më dëgjon.

Fiorela Shalsi – Ju lutem, hapeni mikrofonin që t'ju dëgjojnë të gjithë pjesëmarrësit që janë në sallë.

Migena Balla – Irena, për ne që jemi *online* dëgjohet shumë mirë, ndoshta për ju që jeni aty nuk dëgjohet .

Fiorela Shalsi – Tani ju dëgjojmë, faleminderit!

Vjollca Koko – Ju falënderoj që më bëtë pjesë të këtyre konkluzioneve shumë të bukura, pra të projekteve që ju keni ndërmarrë!

Fjor, unë i di aftësitë e tua, sepse ju kam njohur nëpërmjet Aleancës së Këshilltarëve.

Përsëritës të gjithë pjesëmarrësit, sidomos profesorin Enver Roshi dhe zonjën Gjermani!

Në radhë të parë dua të flas për masat që janë marrë sa i takon kohës që gratë shpenzojnë në shtëpi, duke u marrë me problemet e tyre. Pra, në këtë aspekt dua t'ju përmend se çfarë masash mund të ndërmerren për të lehtësuar kohën që gratë harxhojnë kur kanë një familjar të sëmurë.

Unë jam mjekë reumatologë, nëse edhe profesori më dëgjon, dhe më duhet t'ju them se sa i takon menaxhimit të sëmundjeve në nivel rajonal ne jemi shumë larg. Pjesë integrale nuk është vetëm mjekimi, por në radhë të parë duhet të përmirësojmë shërbimin shëndetësor në mënyrë që ta kemi edukimin si pjesë integrale dhe kjo bëhet nëpërmjet personelit mjekësor në

mënyrë të përditshme ose të vazhdueshme ose nëpërmjet linjave telefonike *online*. Një element të tillë ne nuk e kemi, pra nuk kemi elementin rehabilitues për menaxhimin e të sëmurëve, si dhe mbështetjen psikologjike, por kemi një sistem shëndetësor, të cilit i mungojnë shumë elemente për ta bërë menaxhimin e sëmundjes, për të mos folur më pas për diagnostikimin e hershëm.

Unë doja t'ju flisja vetëm si mjek, por meqenëse jam edhe përfaqësuese e shoqërisë së personave me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë humbur aftësinë për të ecur si rezultat i një sëmundjeje, skleroza multiple.

Duke marrë si shkak edhe fjalën e zonjës Gërmenji, më duhet t'ju them se ne vërtet kemi evoluar dhe e kemi përditësuar legjislacionin që prej vitit 2005 për shërbimet sociale komunitare dhe që prej vitit 2008 është përditësuar edhe legjislacioni për eliminimin e barrierave, por Gjirokastra ende mbetet një qytet me barriera dhe pa shërbime komunitare.

Ne si shoqatë kemi bërë shumë aktivitete për të ndërgjegjësuar drejtuesit lokalë dhe të institucioneve për ekzistencën e legjislacionit dhe për mënyrën se si ata duhej të merrnin masa që t'i eliminonin këto barriera.

Unë mendoj se kur del legjislacioni, në fund duhet të dalë edhe se kush është financuesi apo monitoruesi. Edhe pse ne pasurohemi e pasurohemi me legjislacione, shyqyr Zotit që pasurohemi me legjislacione, megjithatë gjendja në rajon nuk ka ndryshuar. Shoqata që unë drejtoj përfshin të gjithë rajonin e Gjirokastrës dhe deri më sot asnjë gjë nuk ka ndryshuar.

Unë kam qenë edhe këshilltare në këshillin bashkiak dhe më është dashur të bëj shumë punë për të ndërgjegjësuar këshilltarët sa i takon ekzistencës së legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara, për përgjegjësinë që ka pushteti vendor sa i takon marrjes së këtyre masave, duke krijuar fonde sociale në mënyrë që të eliminoheshin barrierat, por përsëri nuk ia dola dot. Edhe pse arritëm të krijojmë një fond ai fond nuk u përdor dhe kjo për shkak se diçka nuk arriti të funksiononte ashtu siç duhet, sepse ka një boshllëk midis hartimit të ligjeve dhe zbatimit, monitorimit dhe financimit të tyre.

Ligji i vitit 2016 “Për marrjen e masave për eliminimin e barrierave” linte një afat 6-mujor, por ne nuk arritëm të shihnim asnjë ndryshim. E njëjta gjë ndodhi edhe sa u takon projekteve të reja që erdhën, të cilat me gjithë luftën që ne bëmë u zbatuan pa respektuar legjislacionin sa u takon personave me aftësi të kufizuara.

Unë e shoh si pjesë shumë të rëndësishme plotësimin e këtij boshllëku që ekziston që me daljen e ligjit dhe deri në zbatimin e tij.

Po ashtu, ne kemi organizuar disa takime edhe në nivel prefekturë, ku prezentë kanë qenë edhe përfaqësuesit e shoqatës së ndërtimit, të cilët na mbështetën, por u shprehën se duhet

të ketë një mekanizëm tjetër më të mirë në mënyrë që ligjet që dalin t'u shkojnë edhe personave me aftësi të kufizuar, sepse këto ligje i njohim vetëm ne, duke u interesuar dhe duke ndjekur në mënyrë të rregullt botimet e Fletores Zyrtare, si dhe gjithë legjislacionin që ka të bëjë me shoqatën tonë.

Pra, mendimi ynë është që këtë legjislacion duhet ta kenë të gjithë drejtuesit lokalë dhe ata që merren me këtë punë.

Kaq kisha për t'ju thënë dhe ju falënderoj!

Fiorela Shalsi – Shumë faleminderit, zonja Vjollca, që e ngrini gjithmonë zërin për çështje të tilla kritike që ju prekin ju, por edhe komunitetin që ju përfaqësoni!

Nuk e di nëse dëshiron dikush tjetër ta marrë fjalën?

Nga paneli sugjerohet që të kemi disa komente dhe sugjerime nga pjesëmarrësit dhe më pas do të mundohemi që t'i adresojmë të gjitha çështjet që ngrihen.

Vjollca shumë faleminderit!

Vjollca Koko – Faleminderit! Ju përshtendës të gjithëve, sidomos profesor Enverin!

Fiorela Shalsi – Shumë faleminderit!

A e dëshiron ndonjë tjetër që ta marrë fjalën?

Bruna Ylviu – Unë quhem Brunja Ylviu dhe jam përfaqësuese e Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin.

Fiorela Shalsi – A mund ta ngrini pak zërin, ju lutem!

Bruna Ylviu - Ju falënderojmë për këtë analizë të thelluar!

Si gjithmonë UNPA-ja, sa u takon analizave, është përpara, duke na dhënë informacione mjaft të vlefshme për të punuar dhe për të bërë politika më të mira në shërbim të komunitetit, sidomos në drejtim të grave.

Po ashtu falënderoj edhe pjesëmarrësit e Kuvendit, që si gjithmonë janë të hapur për të na dëgjuar qoftë ne si përfaqësues të shoqërisë civile, qoftë edhe aktorë të tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave të grave dhe të barazisë gjinore.

Dua të bëj dy komente të shkurtra. Analiza ishte mjaft informuese sa i përket Kodit të Punës lidhur me punën në distancë, rregullat e reja, dhe ia vlen që të gjithë ata që janë të përfshirë në pjesën e punëdhënies të informohen dhe të rifreskohen sa i përket këtij ndryshimi që ka të bëjë me Kodin e Punës, duke qenë se jemi në një realitet ku puna *online* është bërë domosdoshmëri. Dhe një gjetje tjetër, që e vura re te prezantimi i dytë, ishte fakti se gratë në pension paguhen me një diferencë 20% më pak krahasuar me burrat. Ky është një tregues domethënës, për të cilin duhet bërë një analizë më e thelluar, pse është ky hendek në pagesat e pensioneve ndërmjet grave dhe burrave, sepse pensionistët janë një kategori që duhen

mbështetur. Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për pjesën e pensioneve të ulëta dhe të pamjaftueshme për këtë kategori, prandaj mendoj se duhet bërë një analizë e thelluar për sa i përket këtij hendeku.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Përshëndetje!

Unë ju falënderoj për raportin dhe prezantimin në Komisionin për Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë dhe në Nënkomisionin për Barazinë Gjinore. Ndoqa me vëmendje të gjitha gjetjet praktike dhe legjislacionin, megjithëse për ne kjo pjesë është e njohur.

Më tërhoqi vëmendjen, dhe do të doja të ndalesha, konstatimi dhe rekomandimi që bëri zonja Koko. Unë i vlerësoj shumë këto gjetje dhe që të mos mbetet midis nesh, që i njohim këto aspekte, do të doja t'ju bëja me dije që është miratuar një strategji e edukimit ligjor të publikut, ku një kategori e veçantë janë gratë dhe vajzat, njerëzit me nevoja të veçanta, gratë dhe vajzat viktimë të dhunës, por edhe shtresa të tjera në nevojë, pa bërë dallim gra dhe burra. Njëkohësisht është miratuar një plan veprimi, i cili monitorohet nga Ministria e Drejtësisë. Një nga shtyllat është njohja e legjislacionit, që mbron të drejtat e grave në marrëdhëniet e punës, por edhe në aspekte të tjera, siç është aksesimi në drejtësi. E përmenda këtë për të marrë në konsideratë rekomandimin që bëri zonja Koko, për të informuar në grupe të gjera qytetarët për gjetjet e këtij studimi, se jo të gjithë arrijnë t'i lexojnë, t'i aksesojnë ose mund të kenë dijeni që ka studime të tilla dhe, së dyti, për të përdorur të gjitha mundësitë që ka shoqëria civile, por edhe ne si deputetë, që përfaqësojmë zgjedhës dhe jemi në kontakt në zonat tona me zgjedhës, burra dhe gra, për të sensibilizuar dhe për të informuar pikërisht për këto mundësi që ekzistojnë dhe si mund ta ngushtojmë këtë hendek. Prandaj, do të vlerësoja shumë rolin e të gjithë aktorëve të shoqërisë civile, që në fushën e të drejtave të grave organizatat janë pararojë, dhe mundësinë e shpërndarjes së këtij informacioni në çdo zonë, çdo bashki, ose ish-komuna, që tani janë pjesë e bashkive informacionin të gratë dhe vajzat.

Faleminderit!

Fiorela Shalsi – Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Faleminderit!

Unë e ndoqa me vëmendje të gjithë prezantimin dhe nisur nga gjetjet dhe nga një vërejtje shumë serioze, që bëri zonja Koko, mendoj që gjerat të mos mbeten në letër dhe për këto gjëra kaq serioze, që vijnë përmes studimeve tuaja dhe sidomos të pjesa e gjetjeve, ne si deputetë kemi një rol shumë të rëndësishëm. Ne nuk jemi këtu vetëm për t'ju falënderuar, ose për të vënë në lëvizje të gjithë mekanizmat e ekzekutivit, por jemi edhe për të kontrolluar se si implementohen ligjet. Unë propozoj që ky nënkomision, që drejtohet nga një zonjë e nderuar

dhe me kaq përvojë si zonja Gërmenji, por edhe Komisioni i Çështjeve Sociale, është e mundur që, mbi bazën e këtyre gjetjeve, në programin tonë të punës të kemi disa kërkesa për interpelanca, ku drejtuesit e institucioneve kryesore, pra ministrat, të vijnë dhe mbi bazën e kërkesave tona që ndërtohen mbi këto gjetje të na informojnë se çfarë po bëhet për të implementuar ligjet. Unë mendoj se për fushat që po diskutojmë legjislationin e kemi të mirë, por edhe shumë të mirë, por që të zbatohet ne si deputetë duhet ta bëjmë më mirë punën tonë, pra të kontrollojmë si zbatohen ligjet që ne po bëjmë. Një nga mekanizmat që duhet ta shfrytëzojmë më mirë është të ftojme në parlament në seanca dëgjimore dhe pyetjesh dhe interpelanca drejtuesit e ministrive për të na informuar si legjislationi po zbatohet, gjithashtu cilat janë problemet e zbatimit të këtyre ligjeve kaq të mira, vështirësitë që kanë dhe si ato po jetësohen. Në këtë mënyrë e gjithë kjo punë studimore e institucioneve ndërkombëtare, e shoqërisë civile, në bashkëpunim me parlamentin jep edhe një produkt. Ky ishte sugjerimi im.

Ju falënderoj për këto studime të rëndësishme, për gjetjet që të vënë në mendime dhe të bëjnë ta bësh punën pak më mirë, si deputetë, pra gjetjet që vijnë nga shoqëria civile, njerëz si Vjollca, që solli një përvojë nga një realitet shumë konkret nga Gjirokastra.

Faleminderit!

Fiorela Shalsi – Faleminderit, zoti Ulqini për sugjerimet! Ne do të mundohemi t'i adresojmë. Ky është vetëm produkti i parë i projektit. Unë dëshiroj t'ju informoj se ne synojmë që vijim të studiojmë më në thellësi zbatimin, pikërisht, se cilat janë vështirësitë dhe problematikat që kanë sjellë këto lloj statistikash. Ne e nisëm me këtë lloj analize dhe prezantimi të gjetjeve, për të parë se ku jemi dhe mbi bazën e të cilave pastaj të kuptojmë arsyet pse jemi këtu. Siç e thatë edhe ju, është shumë e rëndësishme që ne të kuptojmë vështirësitë që janë në terren, aty ku duam të shohim të prekshme barazinë gjinore, ose përmirësimin e jetës së grave dhe burrave.

Po, zonja Eni.

Eni Mjeshtri – Unë jam Eni Mjeshtri, vij si përfaqësuese nga Qendra për të Drejtat në Punë. Dua t'ju falënderoj në mënyrë të veçantë për këtë studim, që është shumë komplementar, me shumë politika, që momentalisht kërkohen të ndryshohen, unë e di që janë në fokus të qeverisë për t'i ndryshuar, lidhur me mbështetjen dhe fuqizimin e gruas, sidomos në tregun e punës, që është edhe më i rëndësishmi.

Duke qenë se Qendra për të Drejtat në Punë momentalisht është duke u marrë me një studim të mirëfilltë, të parin ndoshta, të trajtimit të dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës, për të parë pak a shumë incidencën në disa sektorë themelorë të ekonomisë shqiptare, duke filluar që nga administrata shtetërore, me sektorë të rëndësishëm privatë, që kanë edhe një

përqindje shumë të lartë të punësimit të grave dhe vajzave, siç është sektori fason, apo sektori tjetër i shërbimit të turizmit. Pra, edhe kjo ka ardhur si një nevojë e qendrës, pikërisht për të parë se ku cenohen gratë në vendin e tyre të punës.

Duke marrë parasysh që ka shumë pjesëmarrës, që janë deputetë, përfaqësues të lartë të komisioneve parlamentare, do të doja të vendosja vëmendjen në ratifikimin sa më të shpejtë të konventës nr. 190 “Për ndalimin e dhunës dhe ngacmimeve në vendin e punës”, që është një konventë e re e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e them këtë, sepse nisma të tilla janë shumë komplementare dhe duhet të shkojnë bashkë.

Unë i ndoqa me shumë vëmendje të gjitha gjetjet e studimit tuaj dhe do të doja më shumë statistika për mënyrën se si gratë dhe vajzat e përdorin lirinë dhe të drejtat që garantojnë ligjet në Shqipëri. Shpresoj që këto të dhëna dhe statistika më të detajuara të jenë pjesë e implementimit në vazhdim të projektit tuaj, pasi do të kishin një vlerë shumë të veçantë.

Unë mund t’u jap një statistikë shumë interesante të vitit 2018 të Institutit të Sigurimeve lidhur me numrin total të baballarëve, që kërkonin përdorimin e lejes prindërore dhe në vitin 2018 në të gjithë Republikën e Shqipërisë ishin vetëm 250 baballarë që kishin kërkuar përdorimin e lejes prindërore. Kjo tregon pak a shumë sa i largët është ende hendeku në marrjen e përgjegjësisë prindërore, si dhe në ndarjen e detyrave.

Nuk mund të flas përtej fokusit të punës sonë, por është shumë i rëndësishëm implementimi adekuat, sidomos i ligjit të punës dhe ligjeve të tjera, që do t’u hiqte grave atë barrë të madhe që u jep puna, duke mbajtur parasysh që gratë e kanë shumë të lartë këtë barrë, pavarësisht se kush janë, me se merren, çfarë statusi shoqëror kanë. Të gjitha ne përballemi me një barrë të shtuar në familje. Pra, nëse ne do të mundeshim që ta lehtësonim, nëpërmjet zbatueshmërisë së saktë, sidomos të atyre ligjeve të punës, atëherë do t’u garantonim grave fuqizim më të mirë ekonomik, sepse një grua që është më e fuqishme ekonomikisht, dëgjohet edhe më mirë brenda familjes, sepse asaj i nevojitet më shumë asaj, fëmijëve dhe gjithçka tjetër. Ky është këndvështrimi im, ose ky është fokusi që do të doja të sillja si një qendër burimore e të drejtave në punë.

Ju falënderoj!

Fiorela Shalsi – Faleminderit, Eni, për komentet e vlefshme, sigurisht edhe për statistikat shumë interesante, që i shtohen listës së gjetjeve që ne kemi bërë!

Duke qenë se ky lançim që po bëhet sot përfshin në pjesët e tij e marrëdhënien e sugjerimeve dhe rekomandimeve që po zhvillohen pikërisht tani, do të mundohemi që këtë të dhënë ta shtojmë si pjesë të raportit, sepse është e dhënë vërtet interesante.

Është dikush tjetër që dëshiron të marrë fjalën?

Po, Olta.

Olta Koçi – Përshëndetje!

Nisur edhe nga fjala e Vjollcës, ne kemi vënë re jo vetëm në Gjirokastrë, por në të gjithë Shqipërinë që kemi një problematikë për zbatimin e ligjit, gjithashtu edhe mosnjohje apo mospasje informacioni.

Shumë faleminderit, gjetjet ishin interesante, studimi po ashtu, nuk po hyj në detaje, por ajo që do të doja të hyja në thelb është pikërisht mënyra se si të ndihmojmë për shtrirjen dhe marrjen e informacionit nga ligji, rregulloret e me radhë. Do të ishte mirë që të fusnim elemente, që mund edhe të mos jenë të drejtpërdrejta, por të ndërthurura ose të ndërmjetme. Për shembull, për trajnimet në kuadër të programeve të shëndetit që ne zhvillojmë, do të ishte shumë mirë të fusim edhe elementet që ju thatë për gruan shtatzënë dhe për ushqyerjen me gji, ndërkohë që nuk është drejtpërdrejt element i shëndetit, por mund ta fusim si element për t'ua dhënë mjekëve dhe infermierëve, ata pastaj informacionin t'ua japin grave shtatzënë. Pra, le të themi që këto informacione dhe gjetje le t'i përfshijmë në punën tonë në manuale dhe kurrikulat që zhvillojmë, dhe jo vetëm në manualet dhe kurrikullat që lidhen me fuqizimin e gruas, dhunën gjinore apo punësimin, por edhe ato që lidhen jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me to. Për shembull, flas në kuadër të programeve të standardizuara për shëndetësinë, për programet që lidhen me trajnimet dhe jo vetëm për trajnimet e drejtpërdrejta, por edhe seancat e ndërgjegjësimit. Këto mund të jenë elemente, që janë me të vërtetë të rëndësishme për të dhënë informacione edhe në institucionet vendore, gjithashtu edhe te përfituesit, në mënyrë që të rritet kërkesa. Në momentin që kemi kërkesa për shërbimet, atëherë do të kemi edhe implementimin e ligjit për marrjen e këtyre shërbimeve. Të mos kërkojmë implementim e ligjit vetëm nga shteti, por të fillojmë të rrisim kërkesën nga institucione të ndryshme dhe nga vetë përfituesit.

Mendoj që të bëhet sa më efektive futja e gjetjeve në të gjitha ato elemente të punës sonë të përditshme që kemi si me qeverinë vendore, me atë qendrore, por edhe me përfituesit e drejtpërdrejtë.

Faleminderit!

Fiorela Shalsi – Faleminderit, Olta!

Në fakt, ky është një nga qëndrimet kryesore, siç e përmenda edhe unë në fillim, ne synojmë që jo vetëm për përdorim individual, pra një informacion në nivel individual, por edhe profesional-shoqëror, sepse një nga komponentët më të rëndësishëm të projektit është pikërisht komponenti shoqëror, ku ne dëshirojmë të thyejmë stereotipe apo dëshirojmë që të gjithë përfituesit, e para, të informohen dhe pastaj të angazhohen më shumë për t'i gëzuar të drejtat dhe mundësitë që kanë, por edhe për të përfituar nga këto lloj informacionesh.

Shumë faleminderit! Sigurisht që kontributi juaj do të jetë me shumë vlerë. Në fakt, ditët në vijim, sot ose nesër, tek të gjithë të ftuarit do të ndaj patjetër tre *fact sheet*-e, që kanë qenë edhe pjesë e prezantimit, të dhënat e të cilave mund t'i përdorni e t'i integroni menjëherë që sot ose nesër.

Shumë faleminderit!

Nëse ka folës të tjerë nga pjesëmarrësit, fjala është për ju.

Po, Migena, faleminderit!

Migena Balla – Përshëndetje të gjithëve!

Është kënaqësi të jem në këtë panel.

Meqenëse unë vij nga Vlora, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj edhe dy mekanizma lokalë, që, për mendimin tim, në sfidat që shoqëria shqiptare ka kundrejt barazisë gjinore janë shumë të rëndësishme: komisionet e barazisë gjinore dhe aleancat e këshilltareve. Këta janë dy mekanizma që sot gjenden të ngritura në 60 bashki, gati 98% e bashkive, dhe janë funksionale. Këta dy mekanizma do të jenë një dorë dhe një zë më shumë për luftën që duhet të bëjmë të gjithë së bashku.

Aleanca e këshilltareve përfaqësohen edhe me një format kombëtar në aleancën kombëtare. Janë duke u përgatitur zgjedhjet për Aleancën e re Kombëtare, ndërkohë që është bërë gati edhe një paketë ndryshimesh që mendohet, vjen nga niveli lokal, por që duhet lobuar në nivel qendror për sa u përket disa ndryshimeve ligjore, domethënë disa ligjeve që prekin drejtpërdrejt mundësitë e grave dhe të vajzave të gjitha niveleve, por sidomos edhe ato gra e vajza që janë viktima të dhunës ose viktima të mundshme të dhunës.

Aleanca Kombëtare i ka bërë gati, po edhe si pjesë e Këshillit Konsultativ, por edhe në bashkëpunim me Aleancën e Deputeteve së shpejti do t'i diskutojmë në një tryezë të përbashkët këto ndryshime, për t'u ardhur në ndihmë të gjitha grave dhe vajzave dhe për të arritur, në fund të fundit, atë që e kemi të gjithë si sfidë barazinë gjinore.

Duke u nisur edhe nga titulli, por duke parë edhe pjesëmarrësit, unë mendoj se ne do të kemi më shumë zgjedhje nëse pjesë e zgjidhjes do të ketë më shumë burra. Me këtë ju falënderoj edhe një herë për punën e mirë që është bërë.

Ju, Fiorela, keni qenë pjesë e fillimeve të ngritjes së këtyre dy mekanizmave dhe mua më vjen mirë që do të vazhdojmë në të njëjtën linjë. Madje, vetofrohemi në njëfarë mënyre edhe si mekanizma lokalë për të bërë më të mirën.

Faleminderit!

Fiorela Shalsi – Shumë faleminderit, Migena!

Patjetër, edhe arsyeja pse ju jeni këtu është pikërisht sepse nuk i ngremë mekanizmat kot, por pikërisht që të vazhdojmë të shtojmë rrjetin dhe bashkëpunimin në të gjitha nivelet, në të gjitha rajonet, në mënyrë që edhe impakti i këtyre ndryshimeve të mos jetë vetëm në Tiranë, gjë që unë e kam shumë për zemër, por të shtrihet në të gjithë Shqipërinë.

Madje, ju falënderoj shumë, shumë, që jeni të pranishme sot këtu!

Kam kënaqësinë pikërisht t'ia jap fjalën Irenës nga Korça.

Shumë faleminderit, Irena!

Irena Nikaj – Të lutem!

Faleminderit!

Unë ju përshëndes të gjithave dhe të gjithëve, si dhe ju uroj vërtet për këtë ngjarje që po e krahasoj me Konferencën e Pekinit për Shqipërinë, sepse mendoj që është shumë e rëndësishme të flasim për një çështje të tillë, e cila fokuson dhe adreson disa prej problematikave që unë mendoj se janë koncepte kyçe për të ndryshuar Shqipërinë e këtyre 20 vjetëve apo 30 vjetëve të ardhshme, siç është fuqizimi i grave dhe rritja e ndikimit dhe forcës së tyre në të gjitha fushat e shoqërisë, por sidomos kur vjen fjala për qeverisjen dhe për fuqinë ekonomike të tyre.

Ajo që dua të theksoj, duke u nisur nga përvoja që kemi krijuar në kuadër të veprimtarisë si anëtare të Këshillit Bashkiak dhe të Aleancës Kombëtare të Këshilltareve ka të bëjë me vlerësimin e nismave në këtë kuadër për fuqizimin ekonomik të grave, të cilat në përputhje me shtresëzimet dhe grupimet janë adresuar në mënyrë të tillë që të ndihmojnë dhe të mbështesin fuqizimin ekonomik të tyre dhe, njëkohësisht, pjesëmarrjen sa më të gjerë nga anëtarët e këshillit bashkiak në këto nisma.

Në këtë kuadër, duke vlerësuar gjithçka që është ndërtuar nga Kombet e Bashkuara për gratë, ku Fiorela ka dhënë ndihmesën e saj, edhe tani në këtë kuadër me të gjitha ato projekte janë përpjekur të ndërtojnë një punë me të vërtetë thelbësore në nivelin vendor për këtë çështje, unë do të doja që të kishim edhe më shumë veprimtari, të cilat i shpëtojnë, nuk janë me natyrë politik, por i ftojnë sa më tepër gratë dhe burrat të bëhen pjesë e këtyre nismave.

Për këtë arsye, sidomos në nivelin vendor, mendoj se këto veprimtari, me këtë kombinim shpesh *online*, shpesh drejtpërdrejt, ballë për ballë, ne mund të rrisim shkallën e ndërëgjegjësimit apo të vetëdijesimit të grupeve të grave dhe të burrave në nivelin vendor për ta bërë këtë ndryshim. Kjo lejon që të kemi edhe specifika. Korça ka specifika të tjera, Dibra ka specifika të tjera, Tropoja ka specifika të tjera. Pikërisht përmes këtyre bashkëpunimeve na lejohet një qasje që do të sjellë vërtet ndryshime cilësore në rritjen e politikave që ndikojnë në

ekuilibrin gjinor, në rritjen e të drejtave të grave, por edhe në përmirësimin e jetës sociale, politike dhe kulturore të rajoneve apo të zonave në të cilat jetojmë.

Kështu, duke bërë një vlerësim shumë të madh të të gjitha këtyre që kanë ndodhur, e shikoj të nevojshme që ndoshta të këmbëngulim të gjithë edhe në nivel vendor, edhe në nivel qendror për të ndërtuar politika sa më dinamike, ndoshta edhe të gjera. Të synojmë te shtrirja, te zgjerimi, në mënyrë të tillë që të sigurojmë që Shqipëria është po aq dinjitoze në Tiranë dhe në pjesët e tjera.

Unë mendoj që Shqipëria duhet të ridimensionohet tashmë si një etnitet ose si një shtrirje, e cila duhet të jetë cilësore edhe në ato që do t'i quanim “periferi vendore” ose “rajonale”.

Me vlerësimet më të larta për ju, faleminderit!

Fiorela Shalsi - Faleminderit shumë, Irena!

Kam kënaqësinë t'i jap fjalën zonjës Gjermani, sepse në fakt jemi edhe në kufijtë e kohës, për ndërhyrjen e saj.

Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Shumë faleminderit, Fjorela!

Shumë faleminderit të gjithë pjesëmarrësve që, megjithëse takimi është online, ishin vërtet shumë aktivë! Falënderoj shumë kolegët deputetë, gra edhe burra në fakt! Kjo çështje jo vetëm që na përket të gjithëve, por ju po e shikoni që ka angazhim dhe vullnet nga të dyja gjinitë, të paktën i kemi të pranishme edhe me zë, edhe me figurë.

Ndër gjërat që u paraqitën sot në raport, them që kishte gjetje dhe të dhëna që na bënë të mendojmë shumë dhe të shikojmë që na duhet të reflektojmë për të ndryshuar ca gjëra. Sigurisht, prezantimi ishte i përmbledhur, ndërkohë që ka edhe gjetje, edhe rekomandime, për të cilat do t'i kërkoja UNFPA-së, që në mënyrë të përmbledhur, pa dyshim të na vihen në dispozicion, të gjithë kolegëve deputetë, të gjithë pjesëmarrësve. Kërkoj këtu bashkëpunimin e juve që ishit pjesëmarrës të shoqërisë civile, të UNFPA-së me ekspertizën e duhur, me sugjerime konkrete, për sa u përket përmirësimeve ligjore, në qoftë se duhet t'i bëjmë, pa dyshim edhe në qoftë se na duhet të hartojmë ligje të rinj.

Në një sërë ministrish, por në rastin konkret në Ministrinë e Çështjeve të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, po punohet për hartimin e strategjive të reja për barazinë gjinore për vitet në vijim, kështu që jemi në momentin e duhur, që këto kontribute të ndërthuren, të përdoren dhe të adresohen në këto strategji që po hartohen, se kështu i shërbejmë qëllimit të përbashkët. Përveç përmirësimit ligjor që u përmend këtu, pa dyshim dua të theksoj edhe faktin e një sërë konventave ndërkombëtare që Shqipëria ka ratifikuar. SIDO është njëra prej tyre,

kundër diskriminimit të të gjitha formave apo dhe konventa që është në proces ratifikimi dhe unë e falënderoj Enin, që edhe sot e bëri prezent shqetësimin që ka për ratifikimin e konventës së ILO-s, për dhunën dhe ngacmimin seksual në punë. Është në kryeministri, është çuar nga Ministri e Ekonomisë dhe Financave dhe jam në kontakt që kjo gjë të ndodhë sa më shpejt dhe do të kemi një mekanizëm tjetër për të mbrojtur gratë, sidomos në fushën e punësimit në tregun e punës dhe do të jemi një nga vendet e para, shpresoj që ta ratifikojmë këtë konventë, që t'i mbrojmë më mirë gratë. Por jemi të bindur, që i gjithë ky legjislacion ka vështirësi në zbatimin e tij shpeshherë nuk njihet, shpeshherë nuk respektohet dhe nuk zbatohet.

E falënderoj doktoreshë Vjollcën, e cila ngriti një shqetësim shumë të drejtë dhe duke qene se më ka qëlluar të kem në përvojën time 4 vjet si ministre e Zhvillimit Urban e kam ndierë këtë shqetësim, pavarësisht se në ligj është shkruar në mënyrë eksplicitet aksesit me aftësi ndryshe, sërish ka problematika në zbatim.

Ndërkohë, dua të them një përvojë shumë të shkurtër, kur kemi miratuar projektet e rilindjes urbane, fondit të zhvillimit të rajoneve. Unë këmbëngula që një nga kriteret të ishte në fakt respektimi dhe zbatimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara dhe më thanë të gjithë që kjo është në ligj, pse do ta vësh këtu. Në fakt, është në ligj, por jo të gjithë jemi kaq të ndërgjegjësuar dhe kaq të kujdesshëm për ta zbatuar atë. Kështu që, shqetësimi është shumë i drejtë dhe besoj që një lloj përgjigjeje mori nga i gjithë grupi, por edhe nga ne, për sa i përket rritjes së mënyrës sesi e monitorojmë zbatimin e ligjit qoftë në nivel vendor, qoftë në nivel qendror.

U përmend këtu hendeku gjinor, qoftë në paga, qoftë në pensione dhe unë bashkohem me Brunën, që tha se janë gjëra që duhet të thellojmë studimin për to, të shikojmë problematikat dhe të mund të mendojmë si mund t'i adresojmë, se vërtet them që një brezi që i jemi borxhlinj, në fakt janë personat e moshuar, moshë e tretë, të cilët kanë sakrifikuar gjithë jetën dhe jo gjithmonë e marrin mbrapsht atë që kanë dhënë. Kështu që, besoj se duke adresuar këtë pjesë, mund të jemi edhe më të ndjeshëm edhe i përgjigjemi më mirë nevojave të tyre, por në përgjithësi kemi më shumë nevojë.

Raporti është një mjet, por pjesa tjetër që unë mendoj se kemi nevojë, është që kemi nevojë për analiza dhe studime të thelluara, për çështje që lidhen me tregun e punës, duke parë problematikat në detaje, dinamikat që ka dhe si mund të adresohen ato qoftë përmes mënyrës sesi vende të Bashkimit Europian e kanë bërë këtë gjë, qoftë praktika të mira, që e theksoj, mund të ekzistojnë dhe në Shqipëri. I kërkoj UNPFA-së, që për çështje që këtu u diskutuan dhe u nxorën si gjetje nga raporti të mund të bëhen studime të thelluara, qoftë nga organizatat lokale

apo universiteti, ekspertizë lokale për të na nxjerrë në pah këto problematika, që të adresohen më mirë në politikbërje apo në ndryshim ligjesh.

Vlerësoj shumë angazhimin dhe kontributin e grave në Aleancën e Grave këshilltare në nivel vendor dhe gjithmonë i falënderoj për nismat, ndonjëherë të vogla në dukje, por impakti që kanë në komunitet është shumë i madh dhe vërtet i përgëzoj dhe ju uroj të gjithave me zemër shumë suksese, ju kemi goxha mbështetje në nivelin vendor.

Për sa i përket tregut të punës, sigurisht e kemi studiuar, e kemi diskutuar edhe në seanca dëgjimore në nënkomisionin e barazisë gjinore. Ka probleme, sidomos për sa u përket të drejtave të grave, sidomos në fasoneri, edhe tani në periudhën e COVID-it, por në përgjithësi ka problematika. Pavarësisht se është rritur paga minimale, pavarësisht se ligjet janë ndryshuar, monitorimi ka nevojë të jetë më i vazhdueshëm dhe më i qëndrueshëm. Kështu që, gratë në këtë sektor, sidomos, kanë nevojë për më shumë mbështetje dhe më shumë politika, që t'i fuqizojmë më shumë

Them që raporti i sotëm na ka vënë më shumë në mendime, që gjithçka e mirë që është bërë është vetëm fillimi. Sfidat që kemi përpara janë goxha të mëdha. Unë kam besim dhe e theksoj që, vullneti politik është i madh. Kemi angazhimin e të gjithë Parlamentit. Kohën tani nuk e kemi shumë në favor, duke qenë se zgjedhjet janë përcaktuar në prill. Sigurisht, Parlamenti përfundon tani, fillon punën në janar dhe do të jetë një periudhë relativisht e shkurtër. Në qoftë se kemi gjëra konkrete, imediate, ju lutem na i dërgoni, diskutojmë sugjerimet tani që të mund të përgjigjemi sa më shpejt të kemi mundësi në sesionin që fillon në janar.

Shumë faleminderit edhe një herë!

Faleminderit të gjithëve!

Ju uroj gjithë të mirat!

Gëzuar festat, se mbase nuk takohemi, qoftë edhe online!

Fiorela Shalsi – Faleminderit shumë, Tina!

Fjala për zotin Roshi, për ta mbyllur.

Enver Roshi – Pjesëmarrja këtu në shumicë është nga gjinia femërore, kurse ne jemi tre, unë Musai dhe doktor Arbeni.

Në mbledhjen që bëmë para disa ditëve për dhunën gjatë COVID-it dhe për përballimin e saj doli problemi i martesave të vajzave në moshë adoleshence, kështu që mbetet për t'u studiuar se si COVID-i ka ndikuar në këto martesë.

Problemi tjetër është ai i pabarazive sociale rurale/urbane. Pra, për të hyrë më shumë në zonën rurale dhe çfarë mund të bëjë shoqëria për integrimin e tyre në pjesën urbane në kuptimin e investimeve qeveritare në aspektin e rrugëve dhe shkollave.

Para disa kohësh ne kemi bërë një studim për fortifikimin e miellit.

Sipas raportit të EDG-it anemia e grave shtatzëna dhe e grave në Shqipëri është në shifra të larta dhe kjo anemi shoqërohet edhe me aneminë e fëmijëve. Vitin e kaluar ne bëmë një përmirësim të jodit, por duam që këtë ta bëjmë që të rritet shëndeti i grave dhe fëmijëve. Mungesa e hekurit ndikon në fuqinë intelektuale dhe koeficientin intelektual të fëmijëve. Ne mund t'i bashkohemi edhe 80 vendeve të tjera që bënë fortifikimin e miellit.

Ana tjetër është që në shkollat fillore dhe nëntëvjeçare janë meshkuj më shumë, kurse në universitete janë femra.

Arsimi nuk lidhet me tregun e punës dhe ky është një problem i madh. Akoma ka departamente dhe fakultete, që, për të siguruar vendin e punës së pedagogëve, marrin kontigjente të tëra studentësh, të cilët në fund fare gjenden jashtë tregut të punës. Unë jam një nga ata që kam mbyllur fakultetin e shëndetit publik në vitin 2014, sepse tregu i punës për këtë profesion u godit keq nga numri i madh i studentëve, me gjithë kërkesat tona të vazhdueshme që numri i studentëve të ishte baras me tregun, 20 veta. Ka 3 vjet që ne kemi 20 studentë në vit në fakultetin e shëndetit publik.

Pra, duhet që kjo gjë të marrë fund njëherë e mirë. Të mos i lodhim studentët 5 vjet në fakultete thjesht për t'i hequr nga rruga. Degët për të cilat tregu nuk ka nevojë të mbyllën dhe pedagogët të gjejnë punë tjetër. Ne jemi për t'u shërbyer njerëzve dhe shoqërisë shqiptare, jo për të paguar me fatkeqësinë e studentëve. Harxhohen miliona lekë për t'i futur këta studentë në universitete, mbahen 5 vjet dhe pastaj nuk gjejnë vende pune. Shumë njerëzve nuk u përputhet vendi i punës me shkollën që kanë.

Siç e tha edhe kolegja ime, këto gjëra duhet t'i kthejmë sa më shpejt në nisma ligjore.

Faleminderit për ftesën dhe gjithçka!

Fiorela Shalsi – Shumë faleminderit!

Nuk e di nëse Elsona ka ndonjë fjalë të fundit?

Elsona Agolli – Shumë faleminderit të gjithëve!

Të frymëzuar dhe ngacmuar nga gjetjet, sidomos nga pjesa statistikore që bëri Blerina, u vunë në pah disa elemente të tjera, të cilat janë përtej çështjeve të barazisë gjinore, diskriminimit gjinor e kështu me radhë. Një gjë që nxori në pah pandemia dhe analizat e shpejta që janë bërë, për shembull analiza në lidhje me impaktin që pati COVID-i në rolin e gruas dhe të burrit në kushtet e mbylljes, të të punuarit nga shtëpia, është çështja shumë më e gjerë dhe

shumë më tepër e rëndësishme, ajo që ne e quajmë “të mos lëmë kërrkënd pas”. Këtu dua të bëj pak jehonë edhe për sa i takon çështjes që ngriti zonja Vjollca.

Në momentin që ne flasim për përmirësimin e politikave gjithëpërfshirëse, politikave miqësore në sektorin privat, me qëllim që të krijojnë mundësi më të mëdha për sa i takon përfshirjes së grave në vendin e punës, qëllimi nuk është vetëm për gratë e shëndetshme, ato të cilat deri tani qëndrojnë jashtë punës, por për të përfshirë të gjithë; njerëzit me aftësi të ndryshme dhe njerëzit që nuk kanë nevojë për aksesueshmëri në vendin e punës.

Pra, qëllimi kryesor i të gjithës dhe që është vendosur si një lajtmotiv, sidomos në kohën e pandemisë, është të mos lëmë askënd pas.

Unë i vlerësoj të gjithë kolegët dhe pjesëmarrësit sot për të gjitha sugjerimet!

Gjithashtu, zoti Enver vuri në pah disa elemente të tjera të rëndësishme për sa i takon çështjeve të raportit jo të barabartë midis djemve dhe vajzave deri në moshën e re, që është i pabalancuar dhe që na çon në një tjetër praktikë të dëmshme që ka të bëjë me abortin selektiv. Faktikisht ne po punojmë dhe në janar do ju japim mundësinë ta shikoni edhe më thellë nga analizat e thelluara të DHS-së.

Gjithashtu, kemi çështjen e rakordimit midis fronteve të punës dhe kuotave të studentëve për sa i takon futjes në arsimin e lartë dhe ndoshta përmirësimin e edukimit profesional dhe forcimin, sepse jo të gjithë duhet të shkojnë në universitet në një kohë që ka edhe boshllëqe shumë të mëdha për sa i takon aftësive profesionale nëpërmjet arsimit.

Gjithashtu, një element tjetër shumë i rëndësishëm është ai i martesës së hershme. Sikurse e thashë, të gjitha këto në vetvete janë elemente shumë të rëndësishme, janë segmente në rrugëtimin për barazinë gjinore, por edhe për të adresuar stereotipet gjinore dhe praktikat e dëmshme, për të na çuar tek objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe realizimin e këtyre objektivave nëpërmjet përmirësimit të indikatorëve që na e tregojnë atë.

Dëshira është që ne të jemi të gjithë prezentë në salla, megjithatë jemi shumë të lumtur dhe të emocionuar për pjesëmarrjen!

Faleminderit!

Fiorela Shalsi – Shumë faleminderit, Elsona!

Fakti që e kaluam kohën tregon që këto janë tema që në kushte normale do të merrnin ndoshta të gjithë ditën dhe do të ishte me shumë interes t’ju kishim prezentë.

Ju falenderoj për kohën, në një periudhë shumë të ngjeshur dhe në përgjithësi fundi i vitit bëhet i tillë!

Në fakt, në kuadër të projektit ne kishim parashikuar edhe një aktivitet tjetër në fund të këtij viti, por për shkak të kushteve të vështira në të cilat ndodhemi, jemi në pamundësi për t’i

realizuar këto lloj takimesh shumë të rëndësishme, por do ta zhvillojmë në fillim të vitit tjetër. Shpresoj shumë që ky vit të jetë më i lehtë deri në fund, pavarësisht se të gjithë jemi me kohë shumë të kufizuar.

Ju falenderoj për kohën, kontributin shumë të vlefshëm dhe rekomandimet që morëm do t'i reflektojmë!

Ndërkohë, nëse keni komente të tjera, jeni shumë të mirëpritur të na i dërgoni me *e-mail*, nëpërmjet komunikimit me telefon apo çfarëdolloj mjeti tjetër, duke qenë se ne shpresojmë që brenda vitit do ta mbyllim dhe dërgojmë raportin. Shumë shpejt do t'ju dërgojmë të gjitha informacionet e përmbledhura, si dhe të dhënat që ne ndamë, në mënyrë që t'i keni për përdorim të menjëhershëm.

Duke ju falenderuar edhe një herë për kohën, ju uroj festa të gëzuara dhe shpresojmë shumë që viti tjetër të na gjejë më mirë dhe më mbarë!

Gëzuar dhe shumë faleminderit për kohën dhe kontributin!

MBYLLET MBLEDHJA